



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 41 (827739)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 8 Tetor 2021

Konferenca shkencore



Bashkërendimi civil ushtarak në fushën akademike - sfidë e shekullit të 21-të

Objekti kryesor i konferencës shkencore të mbajtur, më 30 shtator në auditorin e Ministrisë së Mbrojtjes, me temë: 'Bashkërendimi civil ushtarak në fushën akademike - sfidë e shekullit të 21-të' ishte 'Arsimi i lartë ushtarak duhet të jetë pjesë integrale e arsimit të lartë publik' Ky aktivitet akademik erdhi si një bash-

këpunim mes Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA dhe Departamentit të Shkencave Politike të Universitetit Barleti. Zëvendësministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, teksa përshëndeti punimet e konferencës vuri theksin në rëndësinë që ka Akademia e FA në projektin për modernizimin dhe...

» faqe 2

Gratë në Politikat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë II

Vajzat dhe gratë në politikat e sigurisë, zv/ministria e Mbrojtjes: Kemi rritur përfaqësimin e tyre në FA



» faqe 3

Shqipëria shton kontributin në NATO

Ministri Peleshi: 21 efektivë të FA do të dërgohen me mision në Letoni

"Ky kontribut ka filluar në vitin 2017 dhe deri më tani kemi dërguar aty rreth 200 efektivë"

» faqe 3



Intervistë me z.Qetsor Orhani

Lidershipi Shqiptar dhe roli i tij në ushtri

Si një studues i konceptit të lidhshpimit ushtarak dhe rolit të tij në periudha të ndryshme kohore. Sa e rëndësishme ishte prania e ushtarakëve të huaj në strukturat e forcave tona të armatosura dhe çfarë roli luajtën ata? Roli i arsimimit të ushtarakëve shqiptarë jashtë vendit gjithmonë ka qenë prezent por në mënyrë të veçantë ai arriti kulmin e vet mbas viteve '90, ku siç dihet me qindra ushtarakë u shpërndanë në të katër anët e globit, ashtu sikurse edhe tek...



» faqe 6-7

Marrëdhëniet diplomatike SHBA-Shqipëri

Ministri Peleshi: 45 vite ndarje nuk e zbehu aspak lidhjen me aleatin tonë strategjik SHBA

Ministri Peleshi: Sot (1 tetor) festojmë 30-vjetorin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me SHBA, vendin që do të shndërrohej në aleatin strategjik dhe të pazëvendësueshëm për popullin tonë. Ndërprerja 45-vjeçare nuk e zbehu aspak lidhjen mes dy popujve dhe sot vendi ynë mban levën e orientimit të krejt rajonit tonë drejt Perëndimit...

» faqe 4

Stoltenberg, vizitë në Uashington DC

NATO në një botë konkurruese dhe forcimi i lidhjes transatlantike

» faqe 11

BASHKËPUNIMI USHTARAK

Në Forcën Ajrore fillon Kursi Bazë i Vëzhgimit Ajror "On job training"

» faqe 2

INMEMORIAM

Forcat e Armatosura janë në zi, se humbën një oficer të përkushtuar e të palodhur

» faqe 5



Konferenca shkencore

Bashkërendimi civil ushtarak në fushën akademike - sfidë e shekullit të 21-të

Objekti kryesor i konferencës shkencore të mbajtur, më 30 shtator në auditorin e Ministrisë së Mbrojtjes, me temë: 'Bashkërendimi civil ushtarak në fushën akademike - sfidë e shekullit të 21-të' ishte 'Arsimi i lartë ushtarak duhet të jetë pjesë integrale e arsimit të lartë publik'. Ky aktivitet akademik erdhi si një bashkëpunim mes Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA dhe Departamentit të Shkencave Politike të Universitetit Barleti.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, teksa përshëndeti punimet e konferencës vuri theksin në rëndësinë që ka Akademia e FA në projektin për modernizimin dhe profesionalizimin e FA.

Dy ishin shtyllat kryesore, ku u përqendruan edhe panelet e konferencës: reformat arsimore në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe qasja e rretheve akademike si kontributorë në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë me punime dhe projekte konkrete.

Konferenca shërbeu si një forum për shkëmbimin e ideve dhe përvojave të ndryshme ndërmjet pjesëmarrësve edhe në konsolidimin e partneriteteve me institucionet arsimore, shkencore dhe kërkimore brenda vendit.

Në kushtet e një mjedisi sigurie kur teknologjia dhe informacioni janë parësore u debatua rreth hartimit të politikave të reja në fushën e kurrikulave në arsimin ushtarak me qasje nga arsimit civil.

Në përfundim të konferencës kryetarja e Bordit shkencor prof. asoc. dr. Zamira Çavo dhe rektori/komandanti i ADA gjeneral brigade dr. Albert Mullai shpërndanë certifikatat për pjesëmarrësit.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, përshëndet konferencën shkencore



Fillon Kursi Bazë i Vëzhgimit Ajror "On job training"

Në Forcën Ajrore filloi Kursi Bazë i Vëzhgimit Ajror "On job training" me personelin e Qendrës së Kontroll - Raportimit.

Kursi zhvillohet në kuadër të Planit të Bashkëpunimit Ushtarak për vitin 2021 ndërmjet vendit tonë dhe Republikës së Italisë.

Në takim me ekipin trajnues italian, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj i falënderoi për mbështetjen dhe realizimin e këtij kursi si dhe shprehu gatishmërinë e thellimit të bashkëpunimit ushtarak në të ardhmen.

Qëllimi i këtij kursi është shkëmbimi i eksperiencave me synim rritjen e aftësive ndërvepruese dhe kapaciteteve të personelit të Vëzhgimit Ajror në funksion të realizimit të misionit dhe detyrave të Qendrës së Kontroll - Raportimit.

Para fillimit të kursit, zëvendëskomandanti i Qendrës së Kontroll - Raportimit, nënkolonel Myslim Rrasa dhe shefi i shtabit nënkolonel Eduart Pllaha njohën ekipin italian me strukturën dhe funksionimin e kësaj qendre si dhe objektivat që kërkohen të arrihen me përfundimin e këtij kursi 4-javor.



Zhvillohet stërvitja "Ambicia e Shqiponjës" në Forcën Ajrore



P prej një jave Qendra e Kontroll - Raportimit ka zhvilluar stërvitjen reale me trupa "Ambicia e Shqiponjës" në vend dislokimin e radarit. Kjo stërvitje u planizua, organizua dhe u drejtua nga Qendra e Kontroll-Raportimit në bashkëpunim me Komandën e Forcës Ajrore.

Skenari i kësaj stërvitje ishte ideuar për të plotësuar misionin, detyrat e repartit në kushte dhe ambiente jo konvencionale dhe realizimin e komandim - kontrollit të mjeteve ajrore si dhe rritjen e masave të sigurisë e të ruajtjes së objekteve me rëndësi.

Stërvitja u ndoq nga shefi i Shtabit i Forcës Ajrore, kolonel Arben Cenolli, shefa kryesore dhe ushtarakë të shtabit të Forcës Ajrore, të cilët vlerësuan përgatitjen dhe realizimin e stërvitjes "Ambicia e Shqiponjës" për përmbushjen e objektivave të caktuara.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Hajrie **DEDAJ**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Shqipëria shton kontributin në NATO

Ministri Peleshi: 21 efektivë të FA do të dërgohen me mision në Letoni

“Ky kontribut ka filluar në vitin 2017 dhe deri më tani kemi dërguar aty rreth 200 efektivë”

Pas mbledhjes së qeverisë, në komunikim me mediat, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi se: Shqipëria do të dërgojë në Letoni 21 efektivë të Forcave të Armatosura, kjo si një prej vendimeve të marra nga Këshilli I Ministrave në kuadër të kontributit të Forcave të Armatosura në misionin e NATO-s në Letoni.

“Ky kontribut ka filluar në vitin 2017 dhe deri më tani kemi dërguar aty rreth 200 efektivë. Ia vlen të theksohet se Letonia është një vend baltik në verilindje të Aleancës sonë, NATO dhe si e tillë misioni aty i Prezencës së Përpunuar ka për synim përbalimin e rrezikut që mund t'i vijë Aleancës nga vendet e Lindjes, por e veçanta e këtij kontributi është se ne kontribuojmë atje jo thjesht me efektivë, por me një specialitet që është i cilësuar NISH. Bëhet fjalë për neutralizimin e municioneve të paplasura dhe ne jemi fokusuar ndër të tjera në këtë specialitet NISH për të qenë të domosdoshëm, të nevojshëm në kontributin e NATO-s në këtë pjesë”, - tha ministri Peleshi. Ministri i Mbrojtjes shtoi se “jemi duke investuar veç të tjerash, përveç modernizimit të Forcave të Armatosura edhe në dije, pra duam që Forcat tona të Armatosura të spikasin edhe në dije, sidomos në aftësimin për përdorimin e teknologjive të reja”.

Po ashtu ministri Peleshi bëri me dije se po investohet sa i përket mbrojtjes kibernetike duke nisur nga rishikimi i institucionit arsimor më të rëndësishëm sa i përket Forcave të Armatosura, që është Akademia e Forcave të Armatosura. “Jemi duke bashkëpunuar me partnerët më të mirë në botë me partnerin strategji SHBA. Me kryeministrin, kemi



pasur një vizitë të zgjeruar në Akademinë në SHBA dhe duam të sjellim atë model këtu, jo vetëm modelin por në fakt dhe kontributin dhe bashkëpunimin që nga kurrikulat dhe deri te dhe stafet akademike nga kjo akademi dhe çështja e Akademisë është ngritur në nivelin më të lartë politik të mundshëm”, - tha z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes ndau me publikun edhe informacionin mbi rritjen e interesimit të rinjve për të studiuar pranë Akademisë së Forcave të Armatosura. “Për 60 vende të reja për tri degë bachelor që ne hapëm këtë vit, kemi patur 1 mijë aplikime. Sot që flasim, që në fazën e parë të regjistrimit, kemi plotësuar të gjitha vendet tona. Kemi dhe projekte interesante, që nuk po i shteroj tani por do i sjell pranë publikut, për një kampus të Forcave të Armatosura, por me mbështetjen e kryeministrit dhe partnerëve besoj do ia dalim”, - tha ministri Peleshi.

hqipëria shton kontributin në NATO, Peleshi: 21 efektivë të FA do të dërgohen me mision në Letoni

Gratë në Politikat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë II

Vajzat dhe gratë në politikat e sigurisë, zv/ministria e Mbrojtjes: Kemi rritur përfaqësimin e tyre në FA

Përfshirja e gruas në politikat e sigurisë dhe mbrojtjes sjell vetëm pozitivitet

Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes dijes dhe zhvillimit të gjeneratës së ardhshme si kontribuese proaktive në politikat e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare ishte në qendër të aktivitetit të organizuar me rastin e fillimit të veprimtarisë së Institutit për Gratë në Politikat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë II, projekt i financuar nga Ambasada e SHBA. Pjesë e aktivitetit ishte edhe zëvendësiministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, ambasadorja e SHBA Yuri Kim, kryetari i Prezencës së ON. Në fjalën e saj përshëndetëse, zëvendësiministrja e Mbrojtjes theksoi se, arsimimi, kualifikimi dhe shanset e barabarta të shtrira në mënyrë kapilare në shoqëri janë mënyra më e mirë për t'i dhënë fund dramës së tranzicionit të gjatë që po lodh deri në sflitje pjesën më të brishtë dhe njëkohësisht më të fortë të shoqërisë tonë, gruan.

Duke u përqendruar tek roli dhe përfaqësimi i gruas në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, zëvendësiministrja Bici u shpreh se krahasuar me vite më parë ka rritje të nivelit të përfaqësimit të vajzave dhe grave, referuar statistika të vitit 2019 dhe 2020.

Po ashtu, shtoi znj. Bici, ka rritje me 2,5% edhe sa i përket numrit të rekrutimeve të vajzave dhe grave në FA, duke vënë në

dukje pjesëmarrjen e tyre në misione ndërkombëtare, në misione të emergjencave civile në ndihmë të popullsisë, në stërvitje, konkurse dhe gara, përherë me një përfaqësim dinjitoz dhe shumë profesional.

Ajo përmendi faktin që zëvendësiministrja e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është një grua, e cila gëzon gradën e lartë të gjeneralmajorit.

Znj. Bici kujtoi edhe “Dëshmoren e Atdheut”, tetare Zarife Hasanaj, e cila humbi jetën e saj të re në krye të detyrës, gjatë misionit ushtarak të NATO, në Letoni.

Pavarësisht arritjeve, zëvendësiministrja e Mbrojtjes u shpreh se, “ka ende shumë për t'u bërë në këtë drejtim. Përfshirja e gruas në politikat e sigurisë dhe mbrojtjes sjell vetëm pozitivitet. Kjo falë mendjes së kthjellët, intuitës së jashtëzakonshme dhe gjykimit racional, karakteristika natyrale këto tek një grua”.



MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE SHBA-SHQIPËRI

Ministri Peleshi: 45 vite ndarje nuk e zbehu aspak lidhjen me aleatin tonë strategjik SHBA

Ambasadorkja Yuri Kim: Ia kemi dalë së bashku

Ministri Peleshi: Sot (1 tetor) festojmë 30-vjetorin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me SHBA, vendin që do të shndërrohej në aleatin strategjik dhe të pazëvendësueshëm për popullin tonë.

Ndërprerja 45-vjeçare nuk e zbehu aspak lidhjen mes dy popujve dhe sot vendi ynë mban levën e orientimit të krejt rajonit tonë drejt Perëndimit

30 vjet më parë, në 15 mars 1991, Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria rivendosën marrëdhëniet e tyre diplomatike.

Aleanca, partneriteti, miqësia dhe besnikëria me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jo vetëm na ka mbrojtur, por edhe ka shumëfishuar ritmet, zhvillimin dhe rolin e kontributit të Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, përkundrazi kufizimeve të natyrshme të një vendi të vogël.

Mbështetja e Shteteve të Bashkuara është edhe sot frymëzimi dhe siguria më e madhe e thellimit të reformave të mëdha në zhvillimin e vendit, rindërtimin e sistemit të drejtësisë, qeverisjen e mirë, luftën kundër korrupsionit dhe përshejtimin e proceseve integruese, si anëtare e NATO-s dhe drejt negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian”.

Ambasadorkja Yuri Kim: Me ngritjen e flamurit amerikan atë ditë në 1991, Chris Hill dhe Andromaqi Adami përçollën mesazhe të fuqishme. Si një diplomat amerikan dhe e veja e dikujt i cili u vra sepse mbrojti Ambasaden Amerikane, kur ata të dy ngritën flamurin, ata përçollën mesazhin se asnjë dënim, asnjë pengesë, asnjë gënjeshtër nuk mund ta shuajë dëshirën për të qenë të lirë. Ata përçollën mesazhin se asgjë nuk është e pamundur kur amerikanët dhe shqiptarët bashkojnë forcat. Dhe ata po përcillnin mesazhin se populli shqiptar dhe populli amerikan janë partnerë dhe miq të përhershëm në rrugën drejt demokracisë dhe çdo qëllimi fisnik që dallon njerëzit e lirë nga ata jo të lirë.

Në tre dekadat prej atij çasti, ne kemi qënë krenarë si amerikanë, të qëndrojmë krah popullit shqiptar, ndërsa ju largonit mbetjet e diktaturës dhe komunizmit për të ndërtuar një komb të lirë dhe demokratik. Dhe nuk mund të ishim më shumë krenarë për partneritetin e palëkundur që të gjithë ju, dhe shumë të tjerë, kanë ndërtuar së bashku. E kemi ndërtuar së bashku midis Presidentësh, midis Ministrash të Jashtëm, parlamentarë, avokatë të shërbimit civil, të gjithë, përfshirë edhe, më rëndësishëm, kolegët tanë shqiptarë në Ambasadë. Dhe do doja të merrja një çast për të veçuar Kastriot Stafën, i cili është kolegu që ka shërbyer më gjatë nga ata aktualisht të punësuar në Ambasadë. Ai ka qenë me ne për 29 vjet! 29 vjet! Ai ka qenë shtylla kurrizore, së bashku me shumë kolegë të tjerë si ai, e marrëdhënies sonë, në kohë të mira dhe të këqija. Kastrioti është sonte këtu me ne!

Shkoni prapa në 1991. Pyes veten nëse dikush në 1991 do ketë mundur të imagjinojë botën, Shqipërinë, marrëdhënien Shqipëri-SHBA, kështu siç është 30 vjet më pas, në 2021. A do kenë patur mundësi të imagjinojnë lidhjet e thella që tashmë janë krijuar midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë? A do kenë patur mundësi ta imagjinojnë Shqipërinë në NATO? A do kenë patur mundësinë ta imagjinojnë Shqipërinë së shpejti në BE? A do kenë patur mundësinë të



imagjinojnë trupat shqiptare dhe trupat amerikane, krah për krah, në konfliktet më të rrezikshme të botës? A do kenë patur mundësinë të imagjinojnë se ndihma jonë ndaj njëri-tjetrit do të ishte e ndërsjelltë dhe e qëndrueshme? A do kenë patur mundësinë të imagjinojnë se Shqipëria shumë shpejt do të jetë anëtare e Këshillit të Sigurisë së OKB-së? Mbase imagjinata e njerëzve në 1991 mund të ketë dështuar, po aty ku ajo dështoi, puna e fortë, mbizotëroi këmbëngulja dhe shpresa e pavdekshme e të gjithëve këtu dhe e bënë atë të mundur.

Më tej ambasadorja do theksonte bashkëpunimin e ngritur ndër vite nga paraardhësit e saj dhe frymën pozitive të shqiptarëve; Ne kemi ndërtuar mbi themelet e atyre që erdhën përpara nesh, ata të cilët patën detyrat që aktualisht na janë besuar ne.

Dhe ne u jemi mirënjohës udhëheqësve nga i gjithë spektri politik, gazetarëve, punonjësve civilë, anëtarëve të shoqërisë civile, anëtarëve të ushtrisë dhe zbatimit të ligjit, dhe shumë të tjerëve, të cilët kanë ndihmuar në ngritjen e marrëdhënies midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, të cilët kanë udhëhequr rrugëtimin e Shqipërisë në kërkim të demokracisë dhe lirisë.

Dhe ndërsa kujtojmë me mirënjohje kontributet e atyre që erdhën përpara nesh, i mbajmë gjithnjë sytë nga e ardh-

mja. E ardhmja! E ardhmja është ajo që ka më shumë rëndësi! Prandaj dhe sonte, jam shumë e kënaqur që kam mundësinë të veçoj udhëheqësit e rinj që janë këtu me ne, përfshirë edhe anëtarët e Këshillit Rinor të Ambasadës. Dhe i ftuari ynë i veçantë i cili u shfaq në skenë, i cili është stër-nipi i Zonjës Adami. E thashë saktë? Të gjithë ne i kemi shpresat tek ky brez i ardhshëm për ndërtimin e marrëdhënieve midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë për 30 vitet e ardhshme dhe me tej.

Dhe duke parë qëndrimin e anëtarëve tanë të Këshillit Rinor dhe energjinë e të ftuarit tonë më të vogël, unë kam besimin se e ardhmja është në duar të sigurta.

Dhe ndërsa ne jemi ende këtu, shpresoj se të gjithë ne do të bëjmë pjesën tonë për të qenë të denjë për trashëgimime e atyre që erdhën përpara nesh, atyre që sakrifkuan kaq shumë për të rilidhur marrëdhëniet diplomatike dhe për të hedhur themelet e një marrëdhënie të fuqishme dhe gjal-

lëruese midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë.

Le të mendojmë mbi të kaluarën, do të vazhdonte në fjalën e saj të rastit ambasadorja Kim, le të mendojmë gjithnjë për të ardhmen dhe le t'i përkushtojmë vetët tona ndaj detyrës për ta bërë këtë miqësi, këtë partneritet, këtë aleancë, më të fortën, më të mirën dhe më madhështoren që ka ekzistuar ndonjëherë.

Dhe le të vazhdojmë duke ecur përpara së bashku, drejt së ardhmes – krah për krah.

Efektivat e Forcës Tokësore në operacionin për pastrimin nga hot-spotet në Poligonin Jubë, Sukth, Durrës

Në kuadër të zhvillimit të operacionit për pastrimin nga municionet e paplasura në hotspotin e Jubë-Sukthit, Durrës, në periudhën 22-23 shtator 2021 është zhvilluar trajnimi për përdorimin e aparatit “Ebinger Large Loop”, nga ekspertë gjermanë, ku në këtë trajnim morën pjesë 26 efektivë të Batalionit të Mbështetjes me Luftim të Forcës Tokësore. Në zbatim të urdhrat të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, për zhvillimin e operacionit për pastrimin nga municionet e paplasura në hotspotin e Jubë-Sukthit Durrës, nga data 27 shtator 2021 ka vazhduar operacioni për pastrimin e municioneve të paplasura në këtë hot-spot. Në këtë operacion janë përfshirë mbi 20 forca dhe 3 mjete të Forcës Tokësore, si dhe specialistë EOD nga KM të cilët janë pajisur me bazë materiale të dedikuara për këto lloj operacionesh.



FJALA E LAMTUMIRËS, NË PËRCJELLJEN E NËNKOLONEL DR. EDLIRA KUKELI

Forcat e Armatosura janë në zi, humbën një oficerë të përkushtuar e të palodhur

Të dashur dhe të nderuar pjesëtarë të Familjes Kukeli!
Të nderuar të afërm të Doktorshë Edlirës,
Të nderuar doktorë dhe infermierë të Forcave të Armatosura!
Të nderuar pjesëmarrës, ushtarakë dhe civilë, në këtë ceremoni të përmortshme! Sot, me dhimbje të madhe, po përcjellim në banesën e fundme, Doktorshë Edlira Riza Kukelin.
Mjekësia ushtarake sot është në zi. Ajo humbi një vlerë, si pak të tjera nga ato që ka. Forcat e Armatosura janë në zi, se humbën një Oficerë të përkushtuar e të pa lodhur. Edlira u lind në Tiranë, më 29 Qershor të vitit 1969. Ajo u lind dhe u rrit në një familje emërmirë, në familjen Kukeli. Dhe u edukua nga dy prindërit e saj intelektualë të kohës, Rizai dhe Vlefa, me vlerat më të mira njerëzore dhe qytetare. Edlira shkëlqeu në të gjitha shkallët e arsimit të saj. Falë rezultateve të larta me të cilat mbaroi Gjimnazin, ajo fitoi të drejtën e studimit në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Është trishtim i madh, të përjetosh ikjen shumë të parakoshme por edhe kaq të papritur të një kolegeje...
Të nderuar pjesëmarrës në këtë Ceremoni të përmortshme!
Është bërë zakoni tanimë, e sidomos në kohët që jetojmë, që kur largohet një njeri nga jeta, të gjallët flasin me fjalët më të mira për të, pavarësisht vlerave reale që i ikuri pati.
Por kur ndodh që Njeriu, Doktorin dhe Ushtarakun, bashkohet në emrin Edlira Kukeli, sado që të thuash, ke thënë pak.

Edhe pse ndodhem në pozicionin e vështirë të them dy fjalë për Nënkolonel Dr. Edlira Kukelin, e para gjë që mund të them, është se ne ende nuk mundemi, e as nuk duam ta besojmë, Ikjen e saj pa kthim. Është e pamundur ta besosh, se njeriu dhe kolegu, me të cilin jo më larg se para disa dhjetra orësh, ke ndarë preokupime dhe shqetësimet e punës, sot nuk është më! Nuk më lejon Dliresia, Mirësia dhe buzëqeshja e Saj, që ta besoj Ikjen e Saj. Portreti i saj, na shfaqet ngado që kalojmë dhe hedhim sytë. Na duket sikur do shkëmbehemi me të, në korridorët e Shtabit të Përgjithshëm, sikur po flasim në telefon me të, për problemet e punës. Dr. Edlira hyn në ata njerëz që janë njëherazi, mjekë të shkëlqyer, njerëz të përkushtuar, e humanë. Njeriu që kurrë nuk tha për një çështje :-“Kjo nuk bëhet, ose unë nuk mund ta bëj”. Doktorshë që kurrë nuk u lodh, në përkushtimin ndaj të sëmurëve, nuk është më!
Bukuria e saj shpirtërore, e shfaqur në bukurinë fizike të saj, bashkëjetonin në harmoni të plotë, me korrektësinë e prerë të ushtarakut, si tek rrallë njerëz të tjerë.
Një vajzë qytetare, jo thjesht dhe vetëm për faktin se ishte lindur në kryeqytet.
Por sepse ishte qytetare, në çdo qëndrim dhe veprim të saj, në çdo lloj marrëdhënieje, pune, apo shoqërore.
Doktorshë Edlira gjatë kualifikimit të saj punoi në Klinikën e Kirurgjisë së Përgjithshme, në Klinikën e Neurokirurgjisë,

në Klinikën e Kirurgjisë Infantile, në Klinikën e Obstetrikë-Gjinekologjisë, si edhe në Reanimacionin Qendror, pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ku arriti rezultate shumë të larta.
Gjatë karrierës së saj ushtarake, ajo ka kryer mjaft detyra të rëndësishme, të tilla si: Shefe e Qendrës Shëndetësore në Komandën e Doktrinës dhe Stërvtjes, Shefe Departamentit të Mjekësisë së Trupës në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës dhe së fundmi shefe për planifikimin shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
Veç këtyre, ajo ishte një studiuese serioze, bashkëpunuese dhe kontribuuese në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo ishte dhe mbetet, e paharruara jonë, Doktorshë Edlira Kukeli. Aq sa e kam ndjerë veten me fat, që puna në Forcat e Armatosura më njohu me një njeri të tillë, po aq e trishtuar dhe e pikëlluar ndihem sot, që më duhet të them këto dy fjalë Lamtumire. Në emër të gjithë respektit që gëzoi kjo Zonjë në jetë,
JU FTOJ TË MBAJME NJË MINUTË HESHTJE!
I PA HARRUAR PËRJETË,
KUJTIMI I DOKTORESHË EDLIRA KUKELIT!
Nga zëvendëshejta e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Manushaqe Shehu

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Një studim për mjekësinë ushtarake...

Dr. Edlira Kukeli u largua nga ne, por ajo na la studimin “Transformimi i mbështetjes mjekësore në FA adaptuar sipas Doktrinës së NATO-s”. Ky material studimi ka qenë në përpjekje për të marrë gradën shkencore “Doktor i shkencave ushtarake”. Studimi është një përpjekje serioze e dr. Edlira Kukelit për të analizuar, trajtuar dhe adresuar qasje të përbashkëta në zhvillimin dhe mbështetjen mjekësore në FA. Bashkëpunimi theksohet në analizë është i shprehur prej Shqipërisë në kontributin e saj në operacionet paqeruajtëse në kuadrin e OKB-së, NATO-s dhe BE-së, duke e shndërruar në një vend që kontribuon në përmirësimin e sigurisë në nivel rajonal dhe më gjerë. Me anë të këtij studimi, ajo synonte të dëshmonte se në nivel rajonal vendi ynë ka një shpërndarje të kontrolluar të balancës së fuqisë me vendet e rajonit dhe prania e NATO-s dhe organizimave të tjerë ndërkombëtare vazhdon të mbetet një faktor i ndërtimit të një sigurie të qëndrueshme të stabilitetit rajonal. Doktrina jonë kombëtare është e ndjeshme dhe pasqyron në kohën e duhur dhe ndryshimet e mundshme në rast kërcënimi ndaj vendit tonë. Gjithashtu studimi synon të analizojë dhe të theksojë se Mjekësia Ushtarake (MU) është një disiplinë akademike e mbështetur në një literaturë të gjerë dhe nga aktivitete shkencore në të gjithë spektrin e specialiteteve mjekësore. Dëmtimet e shkaktuara nga rreziqet mjedisore, armët konvencionale, lëndët kimike biologjike dhe armët bërthamore janë të lidhura me mjedisin ushtarak operativ.

Mjekësia ushtarake përfshin rreziqun, vlerësimin, parandalimin, dispozitat mjekësore dhe menaxhimin klinik të sëmundjeve dhe dëmtimeve që rezultojnë nga ekspozimet në mjedisin ushtarak. Përveç kompetencës teknike në mjekësinë e përgjithshme specialisti i mjekësisë ushtarake duhet të ketë njohuri në fushat e specialiteteve si mjekësia parandaluese, menaxhimi i traumës, mjekësia e mjedisit dhe sëmundjet tropikale infektive. Studimi nxjerr në pah rëndësinë dhe nevojën për mjekësinë ushtarake e cila do të vazhdojë të jetë më e specializuar dhe teknike dhe mbështetja mjekësore do të nevojitet të zhvillojë kapacitetet e specializuara dhe unike që ti përgjigjet kërcënimeve të reja në nivel global. Implementimi i koncepteve doktrinale të NATO-s ka luajtur një rol të konsiderueshëm në zhvillimin e mbështetjes mjekësore në FARSH.

Në realizimin e studimit ka përdorur burime të ndryshme informacioni, analiza dhe studime kërkimore bazuar në këndvështrime të ndryshme të analizës

Dr. Edlira Kukeli dhe studimi që na la si kujtim...



së problemeve të konceptit të Mbështetjes Mjekësore të FA, përshkruan kuadrin mjekësor që kërkohet prej tyre për të ofruar Mbështetje të Shërbimit Shëndetësor eficient për personelin e tij në përputhje me kërkesat e dokumentave të NATO-s që përcaktojnë politikën dhe parimet për mbështetjen shëndetësore operacionale. Ajo gjithashtu përcakton se si strukturat shëndetësore ndërveprojnë dhe kontribuojnë në suksesin e operacioneve që përbëjnë qëllimin kryesor të shtabeve operacionale të planëzimit. Studimi ofron qasje të përbashkëta të njohjes, analizës dhe përbashkëtim të stafeve mjekësore për t'u përshtatur në situata të tilla të reja dhe të zhvillojnë koncepte që të mbështesin operacionet e bashkuara shumëkombëshe. Influenca e faktorëve mjekësorë mbi vendimet operacionale ka çuar në rritjen e kërkesës për zgjidhje mjekësore shumëkombëshe

nëpërmjet stafeve mjekësore të ndikueshëm dhe profesionalë.

Studimi i bërë nga dr. Edlira, është përshkruar, pasi mundëson një përshkrim të hollësishëm të çështjeve që Shërbimi Shëndetësor në varësi të madhësisë së FA dhe burimeve të kufizuara kombëtare, mund të funksionojë me efikasitet gjatë operacioneve brenda territorit të Shqipërisë dhe në ato të dislokuara jashtë në mbështetje të NATO-s apo partnerëve të tjerë. Sistemi i ri i mbështetjes mjekësore në FARSH ka aftësinë të sigurojë standarde të pranueshme të kujdesit mjekësor (Rol 1, Rol 2, Rol 3) duke garantuar vazhdimësinë e kontributit mjekësor në operacionet e NATO-s, në mbështetje të paqes dhe sigurisë në nivel global.

Rreth përmbytjes së studimit
Studimi “Transformimi i mbështetjes mjekësore në FA adaptuar sipas Doktrinës

së NATO-s” u konceptua në shtatë kapituj, ku secili prej tyre trajton në mënyrë të veçantë çështje të veçanta në përbushje të objektivave të studimit me synimin e realizimit të plotë të qëllimit të tij. Në hyrje të punimit pasqyrohet koncepti i përgjithshëm dhe bashkëkohor i mbështetjes mjekësore dhe implementimi i doktrinës së NATO-s. Kjo është e përmbledhur në trajtën e një prezantimi të përgjithshëm në lidhje me problematikën që do të parashtruhet në këtë studim. Më tej, në këtë kapitull parashtruhet problematika e zgjeruar në këtë studim, problemi që do të shtruhet, si dhe referimi tek studimet e tjera të ngjashme në fushën e mjekësisë ushtarake, duke vijuar me qëllimet dhe objektivat kryesore të këtij punimi dhe pyetjet kërkimore të adresuara.

Në kapitullin e parë të punimit përshkruhet historia e mjekësisë ushtarake në vitet 1939-2013, si organizimi i shërbimit shëndetësor dhe mjekësia e luftës në vitet 1939-1944, organizimi i spitalit ushtarak universitar në vitet 1945-2013 dhe Doktrina e mbështetjes mjekësore në operacionet e NATO-s.

Në kreun e dytë përshkruhet koncepti i aleancës për mbështetjen mjekësore në organizimin e mbështetjes mjekësore në operacionet e NATO-s, inteligjenca mjekësore, forca e mbrojtjes mjekësore, vlerësimi i të plagosurve, logjistika dhe komunikimi mjekësor si dhe sistemi i informacionit

Në kapitullin e tretë pasqyrohen strukturat e mbështetjes mjekësore dhe shumëkombëshe, aspekte të bashkëpunimit shumëkombësh, autoriteti dhe përgjegjësia, opsionet e mbështetjes mjekësore shumëkombëshe, si dhe arkitektura e komandimit dhe kontrollit mjekësor shumëkombësh. Gjerësisht në këtë kre trajtohet dhe koncepti i evakuimit mjekësor, evakuimi në tokë, evakuimi në det dhe evakuimi mjekësor në ajër (ae).

Në kapitullin e katërt trajtohet aplikimi i koncepteve të doktrinës së mbështetjes mjekësore në FA ku vend zënë problemet: kontributi i ekipeve mjekësore dhe vlerësimi i motivimit në misionet ushtarake, roli i inteligjencës mjekësore dhe strategjia e vaksinimit në FA, strategjia e vaksinimit të personelit ushtarak në FA, identifikimi i rreziqeve për sigurinë ambientale dhe menaxhimi i stresit operacionel në operacionet e

NATO-s.

Në kapitullin e pestë trajtohen me përparësi problemet si lidhja midis funksionit mjekësor dhe funksioneve të tjera të stafit, menaxhimi i stresit operacionel në operacionet e NATO-s dhe zhvillimi fizik dhe strategjia e vaksinimit të personelit ushtarak.

Në kapitullin e gjashtë përshkruhet organizimi dhe menaxhimi i shërbimit shëndetësor në FARSH, operacionet e inspektoriatit shëndetësor - shërbimit shëndetësor FA, roli i NJMU në transformimin e mbështetjes mjekësore në FA dhe mjekësia e trupës parandaluese.

Më tej vijnë përfundimet dhe rekomandimet që dalin rreth çështjeve të trajtuara në studim. Punimi mbyllet me literaturën që është shfrytëzuar, si dhe me një fjalorth të termave dhe përkufizimeve që janë përdorur në këtë studim.

Mbi qëllimin e studimit

Qëllimi i këtij studimi ka qenë të studiojë sfidat e përshkruara nga mjekësia ushtarake nga viti 1939 dhe deri më sot, si dhe njohjen e konceptit të aleancës për mbështetjen mjekësore, organizimi i mbështetjes mjekësore në operacionet e NATO-s, inteligjenca mjekësore, forca e mbrojtjes mjekësore, vlerësimi i të plagosurve, logjistika dhe komunikimi mjekësor, si dhe sistemi i informacionit dhe komunikimit mjekësor.

Studimi analizon integrimin dhe plotësimin e kërkesave të NATO-s për strukturat e mbështetjes mjekësore dhe shumëkombëshe, aspekte të bashkëpunimit shumëkombësh, autoriteti dhe përgjegjësia, opsionet e mbështetjes mjekësore shumëkombëshe, si dhe arkitektura e komandimit dhe kontrollit mjekësor shumëkombësh.

Koncepti i Mbështetjes Mjekësore të FA përshkruan kuadrin mjekësor që kërkohet prej tyre për të ofruar Mbështetje të Shërbimit Shëndetësor eficient për personelin e tij në përputhje me kërkesat e dokumentave të NATO-s që përcaktojnë politikën dhe parimet për mbështetjen shëndetësore operacionale. Ai gjithashtu përcakton se si strukturat shëndetësore ndërveprojnë dhe kontribuojnë në suksesin e operacioneve që përbëjnë qëllimin kryesor të shtabeve operacionale të planëzimit.

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI

Roli i arsimimit të ushtarakëve shqiptarë

Leadershipi Shqiptar dhe roli i tij në ushtri

Intervistë me zotin Qetsor Orhani

Si një studiues i konceptit të liderit ushtarak dhe rolit të tij në periudha të ndryshme kohore. Sa e rëndësishme ishte prania e ushtarakëve të huaj në strukturat e Forcave tona të Armatosura dhe çfarë roli luajtën ata?

Roli i arsimimit të ushtarakëve shqiptarë jashtë vendit gjithmonë ka qenë prezent por në mënyrë të veçantë ai arriti kulmin e vet mbas viteve '90, ku siç dihet me qindra ushtarakë u shpërndanë në të katër anët e globit, ashtu sikurse edhe tek ne mbërritën qindra ekspertë të tjerë ushtarakë, të cilët asistuan reformimin e Forcave të Armatosura Shqiptare për ta sjellë atë në standartet e kërkuara nga partnerët tanë. Gjatë këtij procesi të gjatë fillimisht u punua me përgatitjen e liderit ushtarak pasi do të ishin pikërisht këta që do të kryenin ndryshimet thelbësore.

Kthimi i ushtarakëve nga vendet ku ata u trajnuan pa dyshim që fillimisht krijoi njëfarë konfuzioni, pasi të gjithë mundoheshin të sillnin përvojat e marra nga arsimimi i tyre në vendin ku kishin studiuar, prandaj shpesh herë ne dëgjoni të flitej për leadershipin ushtarak duke dhënë definicione të ndryshme rreth këtij problemi por, pavarësisht prej tyre thelbi i leadershipit në përgjithësi qëndron në faktin se ai është një proces influencimi tek njerëzit, për të arritur një ose disa synime, objektiva, apo për të përmbushur një mision të caktuar pra, ai është diçka virtuale që duhet jetuar, duhet ndërjerë shpirtërisht dhe duhet bërë pronë e drejtuesit në përgjithësi por veçanërisht i liderit ushtarak, i cili duhet ta përmirësojë atë çdo ditë.

Ja si e përkufizon leadershipin Schwarzkopf, më 8 Maj 2000. "Unë ju them njerëzve se leadershipi është një kombinim i dy gjërave i karakterit dhe kompetencës"

Krahas karakterit dhe kompetencës lideri ushtarak duhet të karakterizohet nga ndjenja e lartë e përgjegjësisë, kështu psh është përgjegjësia e gjeneralëve të cilët duhet të sigurohen që ushtria të jetë gjithmonë e gatshme për të përmbushur misionet kushtetuese, qoftë kjo edhe për luftë nëse do të jetë nevoja.

Të gjithë njerëzit ndikohen nga ajo se ç'farë ata kanë parë, ç'farë kanë mësuar dhe me kë kanë patur të bëjnë, por veçanërisht lideri ushtarak është pikërisht ai që di të punojë me njerëzit. Disa njerëz janë gazmorë dhe buzëqeshin gjatë gjithë kohës, disa të tjerë janë seriozë. Disa liderë hyjnë në një dhomë të mbushur me njerëz të panjohur dhe brenda pesë minutash ambientohen shumë shpejt me pjesëmarrësit, të tjerë e kanë shumë të vështirë të ambientohen. Ka liderë të tjerë ndoshta shumë kompetent por që janë të parhatshëm në situata sociale. Pavarësisht tipave dhe karaktereve të njerëzve është lideri ai që pa dalë nga vetvetja gjen mënyrën dhe rrugën se si do të inspirojë zemrat e tyre.

Trajtimi i njerëzve me drejtësi nga ana e liderit nuk do të nënkuptojë trajtimin e tyre sikur ata të ishin klone të njëri-tjetrit. Në fakt në qoftë se lideri i trajton të gjithë në mënyrë të njëjtë, mund të bëhet i padrejtë, për arsye se njerëz të ndryshëm kërkojnë gjëra të ndryshme prej tij. Në këtë kontekst liderët efektiv janë në



mënyrë të mjaftueshme fleksibël për të përshtatur stilin e tyre të leadershipit dhe teknikat me njerëzit që ata drejtojnë. Disa vartës u përgjigjen pozitivisht me të mirë, sugjerimeve ose shtytjes miqësore, të tjerë kanë nevojë madje duan nganjëherë ngacim me fjalë më të ashpra.

Karakterit njerëzor i liderit përbën pa dyshim aspektin më të besueshëm të një lideri të suksesshëm. Sipas gjeneral Harold K. Johnson; Komunikimi, ose aftësia për të informuar njerëzit mbi atë ç'ka pret prej tyre me fjalë të kuptueshme dhe aftësia për t'ju transmetuar atyre interesin që keni për ta, përbën çelësin për një drejtim të suksesshëm.

Stili i leadershipit pa dyshim që është mënyra dhe rruga e sigurimit të drejtimit, implementimit të planeve dhe motivimit të njerëzve. Sipas studiuesve ushtarakë ekzistojnë tre stile të ndryshme leadershipi: autoritar, pjesëmarrës, dhe delegates. Në jetën e përditshme ne ndeshim në stile të ndryshme drejtimi të cilët varen nga situata, prandaj shumica e liderëve i përdorin të kombinuar të tre stilet e drejtimit, por vetëm njëri prej tyre bëhet dominant.

Pa u zgjatur shumë në trajtimin teorik unë mendoj se drejtuesi, apo lideri ushtarak, nuk duhet ta njehësojë veten me postin që i jepet. Ai lypset të ketë egon dhe personalitetin e tij si njeri. Mund të përmendim shumë emra drejtuesish të cilët, megjithëse janë në pension ose nuk janë më në poste drejtuese, ende kujtohen me respekt. Kjo ndodh sepse drejtuesi me personalitet është i prirur të

krijojë marrëdhënie të tilla me vartësit e bashkëpunëtorët, që ata ta pranojnë atë jo vetëm si "autoritet zyrtar", por edhe si "autoritet shoqëror".

- Në literaturën ushtarake thuhet se, veprimi i komandantit është të "aktivizojë potencialet luftarake operationale, për të krijuar fuqi luftarake", ndërsa funksioni i liderit është të përshtasë fuqinë luftarake, procesi nëpërmjet të cilit një komandant imponon vullnetin me sukses. Kush është roli i leadershipit në pikpamjen tuaj!

Roli i leadershipit është një nga aspektet më thelbësore të suksesit në të gjitha sferat e jetës por, më i spikatur është ky rol në Forcat e Armatosura pasi, ky rol

sot me të drejtë konsiderohet si "frymëmarrja" e kësaj force, pra është pikërisht ai që prodhon adrenalinën e cila ngre lart moralin e ushtarakut duke e çuar atë deri në vetësakrificim. Mjafton të kujtojmë këtu thënien brilante të ish Presidentit të SHBA-së Bill Clinton më 23 nëntor 1999 në Ferizaj të Kosovës: "Kur dolëm në tribunë, ju brohoritët për ne, sepse ju kishit qenë të shtypur, ndërkohë që ne ju qëndruam pranë. Dhe ne përdorëm fuqinë ushtarake për të mundur agresionin e Milosheviçit. Ne e fituam luftën. Por, dëgjoni, vetëm ju mund të fitoni paqen".

Është pikërisht "Fuqia ushtarake" siç e quan Klintoni, pjesë shumë e rëndësishme e fuqisë së një shteti, shumë e

rëndësishme për fitoren e luftës, është pikërisht roli i leadershipit ai që ngre lart zemrat e njerëzve, Klintoni e quan, "ne ju qëndruam pranë", që historikisht ka qenë një faktor shumë më i fuqishëm, për atë që Klintoni e quan "ne e fituam luftën", që në një farë mënyre do të thotë se Kosova, por jo vetëm, asnjëherë në historinë e saj nuk kishte patur aleatë qatë të fuqishëm në anën e saj. Në këto kushte, të mos arrish të fitosh paqen, për leadershipin është një mëkat i madh historik, është shpërdorim i një rasti të tillë që një kombi e një popull nuk i jepen ndoshta asnjëherë në historinë e tij.

-Në korrik të vitit 1943 krijohet Shtabi i Përgjithshëm me leadership ushtarak nga kahe të ndryshme, me leadership ushtarak të spikatur nga orientimi politik i vendit.

A ka qenë parim për liderat e ushtrisë shqiptare ky koncept?

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare leadershipi i kohës filloi t'i jepte ushtrisë formën organizative të një ushtrie brenda shtetit. Duke marrë postin e Komandantit të Përgjithshëm, Hoxha luajti rolin e një kryetari të shtetit, ndërsa Moisiu atë të ushtarakut të mirëfilltë në drejtimin teknik ushtarak.

Spiro Mojsiu, ishte një figurë e shquar ushtarake e kohës. Ai qëndroi në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nga muaji maj i vitit 1944 deri në gusht të vitit 1946. Bedri Spahiu, Dali Ndreu, etj. kishin qenë ushtarakë të karrierës, ata ishin arsimuar në shkolla ushtarake jashtë vendit si psh Dali Ndreu në Itali e Abaz Kupi kishte shërbyer në armën e xhandarmërisë gjatë kohës së Zogut me gradën e majorit.

Jo vetëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ku roli i leadershipit ushtarak ka qenë i pa diskutueshëm por edhe më herët vendit tonë nuk i kanë munguar asnjëherë lidera të suksesshëm të cilët kanë qenë të arsimuar në akademitë ushtarake nga më të njohurat për kohën.

Fillimisht u përkrahën ushtarakët e arsimuar jashtë vendit të cilët mbështetën Luftën Nacionalçlirimtare dhe morrën pjesë intensive në organizimin e saj, por ajo që dëmtoi më rëndë ushtrinë tonë erdhi mbas çlirimit të vendit, ku u denigruan thuajse të gjithë ata që kishin studiuar jashtë vendit dhe në Forcat e Armatosura hyri fryma e partisë në pushtet e cila politizoi çdo qelizë të ushtrisë, duke shmangur në mënyrë të qëllimshme rolin e leadershipit ushtarak, madje më vonë me heqjen edhe të gradave ushtarake, ushtria u shndërua në një organizim të madh politik ku predominonte vija e partisë.

Në periudhën kur BS e udhëhiqte Stalini u hodhën bazat e bashkëpunimit dypalësh politik, ideologjik ushtarak, ekonomik e kulturor. Stalini i dha ndihma ekonomike të konsiderueshme Shqipërisë,





mbështeti bazat e ekonomisë, fuqizoi ushtrinë shqiptare, dha bursa të shumta për arsimimin e lidershipit ushtarak si dhe solli këshilltarë të lartë në thujse gjithë pikat kyçe të drejtimit të ushtrisë dhe të shtetit.

Në periudha të ndryshme, si ajo e pavarësisë, ushtarakë holandezë (në tetor 1913) erdhën në Vlorë dhe dhanë kontributin e tyre në ristrukturimin dhe përgatitjen e xhandarmarisë shqiptare, kurse në qeverinë e Ahmet Zogut nga Austria erdhi kolonel Gustav Fon Myrdac për të drejtuar shtatmadhorinë. Çfarë impakti krijuan ata dhe cilat ishin tiparet dalluese të lidershipit ushtarak në periudhën 1912-1944.

Në këto vite, në Ushtrinë Shqiptare drejtuan kryesisht ushtarakë shqiptarë që ishin përgatitur në Turqi. Kështu psh në kohën e shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemali caktoi si Ministër të luftës Mehmet Pashë Dërrallën, një Gjeneral i arsimuar në Akademinë e Shtatmadhorisë në Stamboll dhe që kishte arritur funksione të larta në ushtrinë osmane. Ishte një nga mbështetësit e tij dhe një ndër inisitorët për Pavarësinë e Shqipërisë, ai kishte qenë komandant i Forcave Ushtarake të Lidhjes së Prizrenit.

Po kështu pranë Dërrallës, i pari Shef i Shtabit të Përgjithshëm u caktua Major Ali Shefqet Shkupi, për të organizuar ushtrinë si kryetar i Shtatmadhorisë, ai kishte përfunduar në vitin 1905 studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Stamboll, me gradën kapiten shtatmadhorie.

Shumë ushtarakë të huaj punuan në Shqipëri pas Shpalljes së Pavarësisë me 1912, mjafton të kujtojmë këtu; grupin e ushtarakëve holandezë të kryesuar prej Kolonelit De Veer dhe majorit Thomson, të cilët ndihmuan në ristrukturimin dhe përgatitjen e xhandarmarisë shqiptare. Leon de Chilarity, hyri në shërbim të Ushtrisë shqiptare që në vitin 1913, ndërsa kapiteni austriak Hasler shërbente si instruktor që prej vitit 1914.

Të gjitha qeveritë shqiptare në vitet 1920-1939 e kanë vlerësuar shumë lart rolin e lidershipit ushtarak si mjaft të rëndësishëm në situatat e vështira që kalonte vendi ynë në këto kohë shumë të turbullta.

Po kështu Ali Riza Kolonja i cili drejtoi ushtrinë në vitin 1920, me gradën gjeneral, u zgjodh ministër lufte nga qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës.

Ai ishte ushtarak karriere, shkollën ushtarake e kish mbaruar në Stamboll dhe Akademinë e Shtatmadhorisë në Gjermani.

Ministri Selahudin Said Shkoza, drejtoi në periudhën 1920-1921 me gradën kolonel, ishte arsimuar në Stamboll. Ai hyri në historinë e Ushtrisë Shqiptare jo vetëm si një ministër mbrojtjeje, por edhe si reformator i shquar. I ardhur nga Ushtria Turke, ai përshtati për kohën ato ligje që ishin të domosdoshme për të rregulluar marrëdhëniet e shtetit me ushtarakun.

Po kështu pa u zgatur mund të përmendim; Mustafa Maksutin, ushtarak me gradën major i arsimuar në Stamboll, Zija Dibra, i arsimuar në Stamboll, Shefik Kosturi, një nënkolonel i arsimuar në Turqi, Ismail Tatzati, një kolonel i arsimuar në Stamboll, Mustafa Aranitasi, kolonel i arsimuar në Stamboll si dhe Kasëm Qafëzezi, kolonel i arsimuar në Stamboll e Vjenë, Xhemal Aranitasi, kishte gradën gjeneral, ishte arsimuar në Stamboll.

Duke parë në prizmin historik, por edhe në atë aktual në drejtim të institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes, mund të themi se, thelbi i lidershipit është aftësia për të dalluar dhe për të përdorur ato modele motivacionale të lidhura që i nxisin të tjerët, pra t'i bësh njerëzit që, vullnetarisht, të bëjnë gjëra që, ndryshe, nuk do t'i bënin, duke i harmonizuar këto modele me misionin sipas kohës vendit dhe subjektit.

-Nisur nga kjo cili ishte roli që luajti lidershipi ushtarak në periudhën e Monarkisë Shqiptare 1928-1939?

Në periudhën e Monarkisë u rrit prania dhe roli oficerëve organizatorë, në vitin 1927, ardhja e misionarëve ushtarakë italianë përcaktoi ndryshimin e sistemit ekzistues, të kalimit në ushtri të tipit të rregullt, të kohës. Ushtria u nda në katër komanda: Komanda e Artilerisë, Komanda e Xhenios, Komanda e Marinës së Luftës dhe Komanda e Gardës. Futja e pajisjeve dhe e armatimeve të reja, rriti fuqinë luftarake të Ushtrisë Shqiptare. Në këtë hark kohor ajo u plotësua me një varg rregulloresh, të cilat ndikuan ndjeshëm në rregullimin e veprimtarisë së përditshme të saj.

Në vitet 1925-1928, pranë Ushtrisë erdhën afro 240 këshilltarë ushtarakë italianë, nën drejtimin e kolonelit Alberto Pariani. Pas punës në Shqipëri, Pariani

u bë më vonë gjeneral korparmate dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë italiane.

Më 20 maj të vitit 1922, major Myrdac u emërua organizator dhe njëkohësisht inspektor i përgjithshëm i Ushtrisë shqiptare, që ishte në riorganizim e sipër. Në këtë post gjeneral Myrdac vijoi të punonte deri në fillim të muajit prill 1939, kur Ushtria shqiptare pushoi së vepruari dhe vendi u pushtua nga agresioni fashist. Gjatë zhvillimit të operacionit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare për çlirimin e kryeqytetit të vendit, forcat partizane kapën dhe arrestuan gjeneral Myrdacin. Ai iu dha për gjykim gjyqit special të luftës, që u zhvillua në Shqipëri pas Çlirimit të saj, në vitin 1945, që përcaktoi dhe fatin e tij. Gjenerali Myrdac shërbeu për tetëmbëdhjetë vjet në Ushtrinë shqiptare, 1922-1939 dhe 1943-1944.

Një tjetër ushtarak austriak, që erdhi në Shqipëri për të ndihmuar në organizimin dhe përgatitjen profesionale të Ushtrisë shqiptare të viteve 1928-1944, ishte dhe Herman von Kirchneri, ose siç njihet ndryshe baroni Kirchneri. Por ky ushtarak austriak ndryshe nga atdhetari i tij Myrdac nuk pati fatin e tij tragjik.

-Çfarë risie solli lidershipi ushtarak pas çlirimit të vendit?

Mbas çlirimit të vendit, ashtu sikurse folëm pak edhe në fillim të intervistës, formimi i ushtarakëve shqiptarë u bazua kryesisht në arsimimin e tyre në akademitë e ish BS deri sa u hodhën bazat për krijimin e një serie shkollash ushtarake të cilat luajtën pa dyshim rolin kryesor në përgatitjen e lidershipit ushtarak me vlera ushtarake të pa diskutueshme për vendin, por që në prizmin doktrinar nuk kishin asnjë lidhje me strukturën që pritej të ndërtohej në vend pas shëmbjes së komunizmit. Lufta e Ftohtë ashtu sikurse në shumë vende të lindjes sidomos mbas daljes nga Traktati i Varshavës çoi në bunkerizimin e vendit. Organizimi i fortifikimit ishte një punë kolosale, me shpenzime të jashtëzakonshme, pjesë e logjikës izoluese të regjimit. Ajo solli degradimin gradual të ish-Bashkimit Sovjetik, i cili kishte konsumuar mjaft nga energjitë e tij të brendshme, resurset ekonomike e teknologjike, kishte brejtur brënda tij gjithë strukturat si dhe kishte dëmtuar në planin e jashtëm aleancat satelitore. Këtë periudhë H. Kisinger e karakterizon me fjalët: “..Kurrë ndonjë fuqi tjetër botërore

nuk është shpërbërë tërësisht dhe kaq shpejt, pa humbur në luftë”

Edhe mbas çlirimit të vendit ishte Mehmet Shehu i cili ishte arsimuar në kolegjin e Napolit dhe Akademinë “Voroshilov”. Ai ishte Kryeministri me jetëgjatë i Shqipërisë deri në ditën që u vetvra, që shërbeu edhe si Ministër i Mbrojtjes, 1974-1981, po kështu edhe Kadri Hazbiu, si ministër në vitet 1982-1991, ishte arsimuar në Shkollën e Lartë të Sigurimit në ish-Bashkimin Sovjetik.

Shqipëria është anëtarësuar në NATO, duke realizuar fitoren më të madhe të politikës shqiptare, por në këtë arritje një kontribut të madh kanë dhënë edhe FA të vendit, të cilat “de facto”, me praninë e tyre në misionet ishin prej kohësh pjesë e NATO-s, para se vendi të bëhej “de jure” i tillë. Ushtarakët shqiptarë kanë një përgatitje po aq të lartë sa ajo e vendeve të tjera të NATO-s.

-Si ka evoluar historia e lidershipit ushtarak shqiptar dhe roli i tij në organizimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura parë në këndvështrimin e ditëve tona?

Ishte partneriteti midis Shqipërisë dhe NATO-s si dhe me vëndet anëtare të saj, që rriti dhe intensifikoi bashkëpunimin politik dhe ushtarak, kontribui në angazhimin drejt parimeve të demokracisë dhe rritjes së stabilitetit, transparencës në buxhetin e mbrojtjes, thellimin e kontrollit demokratik në Ministrinë e Mbrojtjes, planifikimin e përbashkët, stërvitjet e përbashkëta ushtarake. Rol të veçantë luajti dhe pjesmarrja direkte e ushtarakëve si në arsimim por veçanërisht pjesmarrja direkte në operacione të përbashkëta duke bashkëvepruar me forcat e NATO-s në fusha të tilla si paqëruajtja, operacionet e kërkimshpëtimit dhe ato humanitare. Një nga vështirësitë e drejtimit në përgatitjen e trupave të këtij lloji, ka qenë mungesa e eksperiencës. Misionet e para paqëruajtëse e filluan përgatitjen në vitin 1995, kur pjesa më e madhe, ose gati gjithë drejtuesit ushtarakë ishin të arsimuar vetëm në shkollën shqiptare ushtarake, në një shkollë vërtet me karakteristika të spikatura, por krejt me koncepte doktrino të tjera. Në ato kushte kërkohet që të përballlohej njëkohësisht si ngarkesa për përgatitjen dhe realizimin e misioneve të caktuara, por edhe të kaloheshin

vështirësitë e reformimit të vazhdueshëm të ushtrisë. Në kujtesën tonë do të ngelen të paharuara fjalët e ish Presidentit Amerikan George Bush, i cili në Samitin e Bukureshtit me 3 prill 2008, tha se: “tre vendet ballkanike e meritojnë ftesën për t’u anëtarësuar, për rrugën e vështirë të reformave që kanë përshkruar, se, kanë ndërtoar shoqëri të lira dhe demokratike e do të japin kontributin e tyre në NATO” Pjesëmarrja në Aleancën më të madhe të të gjitha kohëve i dha siguri të madhe Shqipërisë, i dha liri më të madhe shqiptarëve, iu dha emër më të nderuar dhe lidershipit të asaj kohe dhe atij aktual më shumë besim tek e ardhmja.

Shqipëria, një vend neutral gjatë Luftës së Parë Botërore, sido që neutraliteti i saj nuk u respektua nga palët ndërluftuese, megjithëse nuk hyri në aleanca, nuk krijoi një traditë neutraliteti. Nga viti 1945 deri në themelimin e Traktatit të Varshavës, më 1955, Shqipëria nuk ishte anëtare e asnjë Aleance. Traktati i Varshavës është aleanca e vetme ushtarake ku Shqipëria ka aderuar. Anëtarësimin në Bllokun e Lindjes u ndërpre në vitin 1968, kur Bashkimi Sovjetik pushtonte ushtarakisht një vend anëtar të Traktatit të Varshavës, Çekoslovakinë. Pas vitit 1968 Shqipëria ishte një vend jashtë aleancave të mëdha e brenda izolimit të saj të mbushur me bunkerë në gjithë territorin e vogël, me ekonominë që asfiksiohej dhe me liritë demokratike që gjithnjë e më shumë mungonin. Ndonëse gjatë 95 viteve ekzistencë si shtet, vetëm në 13 vite Shqipëria bëri pjesë në një aleancë ushtarake, por neutraliteti nuk hodhi kurrë rrënjë në ndërjegjien e shqiptarëve. Pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Kinën, Shqipëria nuk bëri pjesë në asnjë aleancë, deri në fillimin e viteve 90, kur shpalli se dëshiron të integrohet në NATO. Vendimi i vendeve anëtare të NATO-s, për të ftuar Shqipërinë i dha asaj mundësinë të finalizojë ato përpjekje dhe atë aspiratë mbarëshqiptare për anëtarësim në NATO. Ende, publiku shqiptar mbetet në treguesit më të lartë të mbështetjes së anëtarësimit të vendit në NATO dhe pjesëmarrjes në misionet të drejtura nga NATO jashtë rajonit. Sondazhet zyrtare nxjerrin një mbështetje rreth 89% të shqiptarëve për NATO.

Që nga anëtarësimi zyrtar i Shqipërisë në NATO ka nisur të zbatohet plani i integritetit që nënkupton reformimin e thellë të sektorit të sigurisë e mbrojtjes me qëllim ndërveprimin e plotë me NATO. Pjesë e këtij plani është paketa me 49 objektiva force të cilat janë marrë përsipër nga FASH si kapacitete operacionale të cilat vihen në dispozicion të NATO për misionet aktuale dhe të ardhshme. Thelbin e tyre e përbën “Grup batalioni i lehtë” i cili përfaqëson një “Task Forcë” me përbërje rreth 1000 veta. Në thelbin e saj është një batalion këmbësorie i lehtë, i motorizuar, i mbështetur edhe me njësi më të vogla (nivel kompanie apo toge) për shërbime zbulimi, mbështetje me zjarr, mbulim nga ajri, shërbim policie ushtarake etj.

Aktualisht, FASH marrin pjesë në misionin ISAF të NATO në Afganistan në disa rajone si Herat (me kontingjentin italian), Kabul (me kontingjentin turk), Kandahar (në misionet speciale me kontingjentin amerikan) etj.

Akademia e Forcave të Armatosura

Përfundon Programi Ekstra-Kurrikular për studentët e Bachelor-it

Programi afroi dhe orientoi studentët drejt njohjes së kulturës, historisë së vendit, përvetësimit të njohurive mësimore dhe stërvitore në terren

Akreditimi i Akademisë së FA si një institucion i arsimit të lartë, nuk është thjesht një mundësi për të përgatitur oficerë më të mirë për nevojat e mbrojtjes e sigurisë. Kjo është edhe një mundësi e jashtëzakonshme për të afruar talente të reja në familjen tonë, djem e vajza që do të shohin tek FA mundësinë reale për të ndërtuar një karrierë, si profesionistë të arsimuar. Në prag të çeljes së vitit të ri akademik për herë të parë AFA realizoi Programin Ekstra-Kurrikular me studentët e Bachelorit të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Koha në të cilën ky Program u zhvillua ishte e vendosur prej datës 7-30 shtator 2021. Qëllimi i këtij programi është synimi dhe orientimi i studentëve drejt njohjes me kulturën, historinë e vendit, përvetësimin e njohurive mësimore dhe stërvitore në terren.

Konkretisht, Programi Ekstra-Kurrikular konsiston në zhvillimin e stërvitjes fushore-ujore në Pashaliman, stërvitjen alpine, vizita në Muzeun Kombëtar dhe Bunk'Art në Tiranë, Kalanë e Beratit, Shkodrës, Monumentet Historike si Varri i Skënderbeut në Lezhë, vizitë në Amfiteatrin e Apollonisë, si dhe vizitë në Komandat e Forcave të Armatosura. Java e parë nga data 7 deri më 10 shtator përfshinte alpinizmin ku studentet do të mësonin ndërtimin e teleferikut dhe zbritjen prej tij, llojet e lidhjeve alpiniste. Java e dytë 13-17 shtator konsistonte në vizitat mësimore vajtja në kalanë e Beratit dhe në Repartin Ushtarak nr.1030 në Poshnje. Vizitë në monumentin e Skënderbeut në Lezhë dhe kalanë e Rozafatit në Shkodër më pas në Repartin Ushtarak nr.1010 në Vau Dejës për tu ndalur edhe në Apolloni dhe Bazën Ajrore të Kuçovës. Java e tretë filloi ditën e diel më datë 19 deri më 24 shtator objektivi kryesor i kësaj jave ishte marshimi, përgatitja fizike që u përqendrua më së shumti në stërvitjen ujore në Bazën Detare të Pashalimanit, Vlorë. Java e katërt dhe e fundit filloi në datë 27-30 shtator, këto ditë studentet vizituan Muzeun Kombëtar dhe Bunk'Art-in, kalanë e Krujës, Forcat Ajrore dhe Policinë Ushtarake. Për tu ndalur në detaje dhe për të mësuar më shumë rreth Programit Ekstra-Kurrikular, idesë së krijimit, stërvitjeve që zhvilluan apo dhe vendeve që vizituan studentet, biseduam me drejtuesit në Departamentin e Formimit Ushtarak.

Kolonel Elton Bregun Shef i Departamentit të Formimit Ushtarak u shpreh se: "Jeta studentore nuk është vetëm brenda klasave, apo stërvitjeve që zhvillohen prandaj për t'i dhënë më tepër mundësi rritjes së frymës në grup, thellimit të dijeve dhe aftësive të tyre në fusha të ndryshme ne menduam të realizonim "Programin Ekstra - Kurrikular". Si pjesë e programit u menduan aktivitete të ndryshme, kursi i alpinizmit për të rritur aftësitë e tyre fizike në ngjitjet dhe zbritjet malore gjithashtu dhe stërvitja ujore në Bazën Detare të Pashalimanit."

Gjatë këtyre ditëve studentët janë shoqëruar nga personeli drejtues i përbërë nga Major Beard Vuçaj, Kapiten Endri Deda, Togere Gliserda Nekaj dhe Reshter Blertjan Maksutaj.

Togere Gliserda Nekaj e cila është pedagoge përgjegjëse në grupin komandues në Departamentin e Formimit Ushtarak, shprehet kështu: "Në këtë vit menduam të bënim diçka ndryshe për të rritur nivelin profesional dhe intelektual të studentëve tanë, u mendua një Program Ekstra-Kurrikular ku brenda tij



Vizitë mësimore në Berat (13.09.2021)



Apolloni, Fier (17.09.2021)

ishin të përfshirë një sërë aktivitete, bazuar në mendimet dhe eksperiencat e stafit të DFU."

Në brendësi të ditëve në Bazën Detare të Pashalimanit-Vlorë (stërvitja ujore)

Studentet e bachelor-it pasi u nisën nga garnizoni "Skënderbej" u dislokuam në Bazën Detare të Pashalimanit, stërvitja zgjati 5 ditë. Pas ndërtimit të fushimit ditën e hënë vijuan me përgatitjet fizike e më pas me njohjen në ambientet e Bazës Detare, Flotiljen dhe Qendrën e Zhytjes. Pasdite u bë ndarja në grupe për të kuptuar aftësitë notuese të studentëve grupi më i mirë, mesatari dhe më pak të mirë. Qëllimi kryesor është që studentët të fitojnë aftësi të mira notuese edhe ata që i kanë t'i përforcuara dhe përmirë-

sojnë. Dita e dytë u kushtua njohjes së ambienteve dhe funksionimit të anijeve në drejtimin e komandantëve, të ndarë në grupe studentët morën një shpjegim të detajuar për mënyrën e funksionimit të tyre. Pas realizimit të lëvizjeve me skaf kur mbërritën në fushim studentët pajisen me veshjet e nevojshme për të bërë zhytjet në det. Gjithashtu gjatë ditës së dytë vizituan Orikun një fshat i braktisur 2500 vjeçar. Dita e 3, gara ndërmjet studentëve ishte dhe pjesa më kulmore që përfshinte disa disiplina, e para ajo e notit me një distancë të përcaktuar, disiplina e dytë ishte zvarritja dhe e disiplina e tretë vrapit me pajime. Gjithsej ishin 6 skuadra që konkurronin me njëra-tjetrën dhe fitimtare dolën 2 prej tyre. Për të rritur frymën e konkurrimit midis tyre

ishite vendosur dhe një shpërblim. Dy skuadrat fituese bënë një vizitë në fshatin Tragjas i vjetër një fshat i pabanuar, por i bukur e me histori duke e bërë akoma më interesant për tu vizituar. Ditën tjetër duke ndjekur rutinën mëngjesit realizuan marshimin sportiv, ngjitjen e Karaburunit deri në Gjirin e Arushës, ose si njihet në hartë gjiri i Bristanit. Ditën e fundit kemi kthimin drejt garnizonit "Skënderbej" me autokolonë, kjo ishte eksperiencia e parë e fushimit ujorë në Pashaliman. Stërvitjen ujore e ndoqi dhe Komandanti i AFA gjeneral brigade Albert Mullai i shoqëruar nga Shefi i Departamentit të Formimit Ushtarak Kolonel Elton Bregu.

Një element që vlen të përmendet është bashkëpunimi jo vetëm në Bazën Detare të Pashalimanit, por me secilën

nga njësitë të cilat bënë të mundur realizimin e Programit Ekstra-Kurrikular në tërësi. Pikërisht kjo frymë bashkëpunimi që vihet re dukshëm mes ushtarakëve është ajo që i diferencion.

Janë 56 studentët të cilët u bënë pjesë e Programit Ekstra-Kurrikular, ata arritën që të plotësonin me sukses objektivat kryesore, forcimin e frymës së grupit dhe thellimin e njohurive në fusha të ndryshme. Duke iu përmbytur masave të Covid-19, mbajtjes së distancës, vendosjes së maskës dhe mbi të gjitha duke u vaksinuar arritën të realizonin në mënyrën më të mirë të mundshme secilën "sfidë" malore, fushore apo ujore.


Për të parë sesi e përjetuan dhe se çfarë mendojnë studentët për realizimin e Projektit Ekstra-Kurrikular, kemi pyetur 2 prej tyre. Ja si shprehet studentja Alueda Vata për gazetën "Ushtria": "Ishte diçka interesante e pa përjetuar më parë duke filluar që nga hedhjet prej kullave, një eksperiencë e bukur, e re. Do të dëshiroja që ky program të përsëritet sërish dhe në vitet e ardhshme. Gjithçka shkoi shumë mirë sidomos në Pashaliman".

Kurse mendimi i student Erisel Mehmetit ishte ky: "Ishte një program shumë i mirë me një shumëllojshmëri aktivitete si njohja e reparteve të tjera, vizita nëpër kala, por sfida e Pashalimanit mbetet më e veçanta ku u ndamë në grupe kështu doli në pah dhe bashkëpunimi mes nesh. Ndoshta shtimi i disa aktiviteteve të tjera do të ishte një mundësi e mirë për ne."

Ky program është vetëm burim dijesh, një gërshetim i historisë dhe kulturës ushtarake, i stërvitjeve ujore dhe marshimeve, i lojërave sportive dhe përgatitjes profesionale, duke marr shkas nga këto ndërthurje përsëritja e tij do të jetë gjëja më e mirë për brezat e ardhshme të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.



Kuçovë (17.09.2021)



“Bashkëpunimi i fuqishëm në mes të dy shteteve tona në fushën e mbrojtjes, përveç interesit të përbashkët kombëtar, është edhe me interes shumë i lartë për paqen, sigurinë dhe stabilitetin e rajonit e më gjerë”, u shpreh ministri Mehaj me këtë rast.



TAKIMI

Bashkëpunimi i fuqishëm Kosovë-Shqipëri, interes i lartë për sigurinë e rajonit dhe më gjerë

Ministri i Mbrojtjes Arment Mehaj i shoqëruar nga zëvendësministri Shemsi Syla, priti sot në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, të shoqëruar nga atasheu i ri i mbrojtjes, Altin Kurti.

Në këtë takim u bisedua lidhur me masat dhe veprimet e duhura që në mënyrë sa më efektive të realizohet Plani i bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.

“Bashkëpunimi i fuqishëm në mes të dy shteteve tona në fushën e mbrojtjes, përveç interesit të përbashkët kombëtar, është edhe me interes shumë i lartë për paqen, sigurinë dhe stabilitetin e rajonit e më gjerë”, u shpreh ministri Mehaj me këtë rast.

Ndërkohë, ambasadori Minxhozi e rikonfirmoi mbështetjen e plotë vëllezërore të Republikës së Shqipërisë për ngritjen dhe avancimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, e në veçanti të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në anën tjetër, ministri Mehaj e falënderoi ambasadorin Minxhozi për mbështetjen e pakursyer të Republikës së Shqipërisë nëpër të gjitha fazat e shtet-ndërtimit nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon Republika e Kosovës.



Ministri i Zhvillimit Rural Damka: Më pak se 10 për qind e grave janë pjesë e sipërmarrjeve në Kosovë

Ministri i Zhvillimit Rural, Fitim Damka ka thënë se më pak se 10% e grave në Kosovë janë të përfshira në sipërmarrje. Ndërsa, Qeveria e Kosovës udhëzohet që të krijojë politikat e duhura që sigurojnë dhe stimulojnë gratë në këtë drejtim.

Kështu u bë e ditur në debatin me temën: Sipërmarrja mundësi reale për të gjitha gratë dhe vajzat në Kosovë, në kuadër të Projektit “Promovimi i Zhvillimit Ekonomik Rajonal përmes Akademia e Ndërmarrësisë”, mbështetur financiarisht nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Ministri Damka tha se kjo ministri në tri vitet e fundit ka mbështetur 141 biznese që udhëhiqen nga gratë.

Damka tha se kjo ministri në vitet e ardhshme do ketë program të veçantë për mbështetjen e sipërmarrjeve që udhëhiqen nga gratë.

“MZHR programet i ka të ndërlidhura mes vete që nënkupton se pas ngritjes së kapaciteteve, idetë kreative për të bërë biznes përmes programeve start-up. Përmes programeve të bizneseve ekzistuese një mundësi tjetër për të bërë biznes duke gjeneruar vende të reja të punës dhe për të qenë të pavarur përmes vetëpunësimit duke zhvilluar procesin e tyre....Gratë në sipërmarrje ende përfshijnë një përqindje të vogël afër 10% MSHR përmes programeve të zhvillimit ka prioritet përkrahjen e grave dhe vajzave në zhvillimin e bizneseve. Disa analiza që janë bërë për tri vitet e fundit në të kaluarën nga 2018 -2020 MZHR ka mbështetur në total 141 biznese të udhëhequra nga gratë, numri më i madh i projekteve përfituese janë gra nga regjioni i qendrës janë 39 përfitues”, theksoi ai.

Ndërsa, koordinatoja e ekipit të Kombeve të Bashkuara në



Kosovë, Ulrika Richardson u shpreh se Qeveria e Kosovës duhet të krijojë politikat e duhura dhe t'i sigurojë gratë se ato kanë qasje të lehtë në vendet e punës.

Sipas saj, fuqizimi ekonomik i gruas është e drejtë e njeriut është gjëja më e mençur e një shoqërie.

“Tani është koha kur duhet të ngremë zërin dhe të sigurojmë se jemi të fuqizuar për t'i zhvilluar këto projekte, sepse gratë përbëjnë 50% të popullatës duhet të jenë në pozicion të barabartë sikurse meshkujt. Kosova e ka me Kushtetutë të ratifikuar edhe Konventën e Stambollit ku është siguruar një rizotim për të luftuar dhunën ndaj femijëve dhe grave. Neve tani kemi mundësinë dhe përgjegjësinë që të sigurojmë që të drejtat e grave janë përm-

bushur... Ka shumë e shumë fusha ku gratë mundën me qenë kreative dhe janë kreative kështu që qeveria ka shumë përgjegjësi që t'i krijoj politikat e duhura, që t'i stimuloj ato dhe t'i siguroj që gratë kanë qasje në ato vende pune ,sepse tek e fundit ka shumë diskriminim dhe përveç këtij nëse je grua që i përket ndonjë minoriteti është problemi i gjuhës ndoshta nuk jeton afër duhet menduar edhe se si të shkosh deri në vendin e punës apo ndoshta ke ndonjë aftësi të kufizuar, pra ka shumë barriera që i prekin më shumë gratë sesa burrat ”, u shpreh ajo.

Drejtoresha ekzekutive e Forumit për Leadership dhe Diplomaci, Njomza Emini tha se përmes këtyre debateve po tentohet të rritet niveli i informacioneve të grave për mundësitë që të jenë udhëheqëse në këtë sektor.

Emini i shpalosi edhe disa nga objektivat kryesore në këtë drejtim.

“Krahas ngritjes së nivelit të informacionit të grave dhe vajzave për sipërmarrje në kuadër të projektit kemi përfunduar objektivat: zhvillimi rajonal përmes nxitjes së grave dhe vajzave nga rajonet e ndryshme të marrin pjesë në aktivitetet të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të tyre në ndërmarrësi. Krijimi i rrjetit jo formal për promovimin e ndërmarrësisë në mesin e grave dhe të rinjve, promovimi i bashkëpunimit në mes shoqërisë civile dhe nivelit qëndror për ngritjen e zhvillimit ekonomik rajonal. Përveç synimit që përmes këtyre aktiviteteve të edukimit joformal që shtojnë nivelin e informacioneve në mesin e pjesëmarrësve do kemi mundësi të krijojmë fushatën vetëdijësuese dhe në fund të krijojmë rrjetin joformal të aktiviteteve që promovojnë ndërmarrësinë”, theksoi ajo.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr Çmimin e Lidershipit Transatlantik CEPA 2021

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mori Çmimin e Lidershipit Transatlantik të Qendrës për Analizën e Politikave Evropiane (CEPA) 2021 më 29 shtator 2021, dhënë si mirënjohje për përkushtimin e tij të palodhur për të avancuar vlerat tona të përbashkëta dhe për të investuar në brezin e ardhshëm të Atlantikëve”.

Në një fjalim të para-regjistruar, z. Stoltenberg falënderoi CEPA-n për punën e saj për të mbështetur bashkëpunimin dhe elasticitetin transatlantik, duke theksuar se lidhja midis Evropës dhe Amerikës së Veriut mbetet “vitale për paqen dhe sigurinë”.

Duke treguar për mjedisin e pa-parashikueshëm të sigurisë, Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi rëndësinë e “forcimit të NATO-s si forumi i domosdoshëm për të gjitha çështjet që prekin sigurinë tonë”, duke shtuar se kjo është në thelbin e agjendës së NATO-s 2030 dhe vendimeve të marra në Samitin e Brukselit në Qershor. Ai vlerësoi përpjekjet e aleatëve për të përforcuar mbrojtjen e tyre kolektive, për të rritur investimet në mbrojtje, përfshirë teknologjitë e reja dhe për të rritur elasticitetin e tyre. Ai më tej theksoi rolin kryesor të NATO-s për të mbrojtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, përfshirë përmes bashkëpunimit të zgjeruar me kombet dhe organizatat e të njëjtit mendim në të gjithë botën. Koncepti i ardhshëm Strat-



egjik i NATO-s, që do të miratohet në Samitin e 2022 në Madrid, “do të përcaktojë një kurs të përbashkët përpara dhe do të rekomandojë aleatët të qëndrojnë së bashku”, përfundoi z. Stoltenberg.

Çmimin e Lidershipit Transatlantik të CEPA për vitin 2021 e morën gjithashtu edhe Sekretari i Shtetit i SHBA Antony Blinken dhe Kryetari dhe CEO i Pfizer, Albert Bourla.

“Mirënjohje për përkushtimin e palodhur për të avancuar vlerat tona të përbashkëta dhe për të investuar në brezin e ardhshëm të Atlantikëve”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s - Përfaqësuesi Special i BE-së

Jens Stoltenberg: NATO mbetet fuqimisht e përkushtuar ndaj stabilitetit të rajonit të BP

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua më 1 tetor 2021 me Përfaqësuesin Special të BE-së, për Dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajčák në Selinë e NATO-s në Bruksel. Gjatë vizitës së tij, Përfaqësuesi Special Lajčák shkëmbeu mendime edhe me Përfaqësuesit e Përhershëm të Këshillit të Atlantikut të Veriut.

“NATO mirëpret aranzhimin e fundit mbi de-përshkallëzimin dhe rrugën përpara në Kosovën Veriore të arritur midis Beogradit dhe Prishtinës, nën kujdesin e Dialogut Beograd-Prishtinë të lehtësuar nga BE.”, tha Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg. “Misioni ynë i KFOR-it luan një rol themelor për të siguruar zbatimin efektiv të këtij aranzhimi, dhe NATO mbetet fuqimisht e përkushtuar ndaj stabilitetit të rajonit të Ballkanit Perëndimor,” shtoi ai. KFOR-i është i mandatuara me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999 për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s mbetet në kontakt të ngushtë me Presidentin Vučić dhe Albin Kurti në lidhje me nevojën për të de-përshkallëzuar, treguar përmbytje dhe kthim në dialog. NATO mbështet fuqimisht Dialogun e lehtësuar nga BE dhe përpjekjet e tjera që synojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës si rruga e vetme drejt arritjes së një marrëveshjeje të qëndrueshme politike dhe stabilitetit për rajonin. Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg vlerësoi bashkëpunimin NATO-BE lidhur me Kosovën si një shembull i shkëlqyer i partneritetit strategjik midis dy organizatave.

Admirali Rob Bauer: Lidhja transatlantike mbetet e fortë

Më 5 tetor 2021, Kryetari i Komitetit Usharak të NATO-s, admirali Rob Bauer priti nënadmiralet Daniel W. Dwyer në Shtabin e NATO-s, në Bruksel, Belgjikë. Takimi i tyre i parë ishte në Norfolk më 27 shtator 2021 gjatë ceremonisë së ndryshimit të komandës për Komandantin Suprem të Aleancës së Transformimit. Kjo është gjithashtu vizita e parë zyrtare e nënadmiralet Dwyer në Shtabin e NATO-s, pasi ai mori komandën e Komandës së Forcave të Përbashkëta Norfolk në gusht 2021, komanda më e re operationale e NATO-s dhe e vetmja e vendosur në Amerikën e Veriut, që sjell Evropën dhe Amerikën e Veriut më afër dhe forcon sigurinë e përbashkët.

Duke u mbështetur në takimin e tyre të mëparshëm në Norfolk në shtator, admirali Bauer dhe zëvendësadmirali Dwyer diskutuan kërkesat në rritje që NATO të ishte e gatshme të frenojë dhe mbrojë në të gjitha fushat, dhe nënvizoi rëndësinë për të siguruar linjat strategjike të komunikimit të NATO-s. “Fushat janë të ndërthurura gjerësisht dhe të ndërvarura. Kjo do të thotë që linjat strategjike të komunikimit jo vetëm që duhet të monitorohen globalisht në internet, tokë, det, hapësirë dhe në ajër, por gjithashtu të sigurohen në të gjithë zonën e përgjegjësisë së NATO-s, e cila është nga toka në infrastrukturën e detit, përmes linjave ujore nën det, sipërfaqen, hapësirën ajrore mbi të dhe deri në hapë-



sirë. Kjo siguron hapësirën e betejave të NATO-s në 360 gradë”, theksoi admirali Bauer. Ai shtoi se “Kordinimi i efekteve operationale nga Norfolk jo vetëm që do të sigurojë parandalimin e vazhdueshëm të suksesshëm të çdo kundërshtari, por gjithashtu do të sigurojë aftësinë për të vepruar herët dhe për të përmirësuar reagimin e NATO-s”.

Që nga shpallja e aftësisë së plotë operationale në korrik 2021, JFC Norfolk ka monitoruar në mënyrë aktive Arktikun, shtegun GIUK-NOR, si dhe Atlantikun e Veriut për të siguruar që linjat strategjike të komunikimit transatlantik të NATO-s të mbeten të hapura në mënyrë që të mbështesin qëndrueshmërinë e Evropës. duke kontribuar në mbulimin 360 gradë të Zonës së Përgjegjësisë së SACEUR. “NATO është e vendosur në synimin e saj për të mbrojtur territorin, popullsinë dhe vlerat e aleatëve. Aftësia e saj për të siguruar dhe kontrolluar Atlantikun e

Veriut dhe GIUK-NOR Gap, siguron lëvizjen e personelit dhe pajisjeve midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Aftësia për të përforcuar dhe mundësuar forcat që veprojnë në Evropën Veriore mbështet besueshmërinë e Aleancës”, nënvizoi nënadmiralet Dwyer.

Misioni dhe detyrat e JFC Norfolk janë që të japë efekte të përbashkëta shumëkombëshe dhe të NATO-s, të ruajë gatishmërinë, të mbrojë linjat strategjike të komunikimit të Atlantikut të Veriut, të parandalojë agresionin, të kontribuojë në reagimin e NATO-s, të sigurojë përforsime dhe furnizime, dhe nëse është e nevojshme fuqinë e projektit për të mbrojtur aleatët dhe partnerët e saj. JFC Norfolk shërben si një lidhje midis aleatëve dhe partnerëve në Atlantikun e Veriut dhe Veriun e Lartë, për të siguruar që aktiviteti të jetë i përafëruar brenda Aktiviteteve Bazë dhe Operacioneve aktuale, për të mbështetur parandalimin dhe mbrojtjen e rajonit Euro-Atlantik.

Nën-admirali Dwyer gjithashtu shfrytëzoi rastin e vizitës së tij për të takuar Drejtorin e Përgjithshëm të Shtabit Usharak Ndërkombëtar të NATO-s, gjenerallejtënant Hans-Werner Wiermann si dhe zyrtarë të tjerë të rangut të lartë.

Kontribut kyç në sigurinë e Aleancës

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s viziton Luksemburgun

Më 4 tetor 2021, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană ishte në Luksemburg ku u takua me zëvendëskryeministrin/ministrin e Mbrojtjes François Bausch dhe ministrin e Punëve të Jashtme Jean Asselborn.

Ai vlerësoi Luksemburgun për investimin e tij në aftësitë mbrojtëse si kontributin kyç në sigurinë e Aleancës. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi gjithashtu Luksemburgun për rolin e tij në çështjet e mbrojtjes së gjelbër dhe ndryshimet klimatike, dhe kontributin e tij të fundit në zhvillimin e një sistemi të ri të NATO-s që do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësisimit të Aleancës mbi situatën në hapësirë.

Z. Geoană vizitoi gjithashtu Agjencinë e Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) dhe u takua me Menaxherin e Përgjithshëm, Znj. Stacy Cummings. Ai falënderoi agjencinë për menaxhimin e aeroportit të Kabulit gjatë evakuimit të personelit, kontraktorëve dhe familjeve të NATO-s në gusht, dhe për ofrimin e mbështetjes thelbësore ndaj përgjigjes së NATO-s ndaj pandemisë COVID-19. Z. Geoană dhe Znj. Cummings diskutuan programet e vazhdueshme dhe të ardhshme të aftësive dhe inovacionit të NATO-s, të cilat, së bashku, ndihmojnë në rritjen e qëndrueshmërisë së NATO-s dhe aleatëve ndaj sfidave të mbrojtjes dhe sigurisë. Në fund, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm vizitoi Bankën Evropiane të Investimeve dhe u takua me Zëvendës Presidentin Kris Peeters. Së bashku, ata diskutuan mundësitë për bashkëpunim, në përputhje me agjendën e NATO-s për vitin 2030 dhe në mbështetje të bashkëpunimit NATO-BE.

Stoltenberg, vizitë në Uashington DC

MSC. MIMOZA GOLIKJA

NATO në një botë konkurruese dhe forcimi i lidhjes transatlantike

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg vizitoi Uashington DC (3-5 tetor 2021), për t'u takuar me zyrtarë të lartë të Shteteve të Bashkuara dhe ligjvënës. Më 4 tetor 2021, z. Stoltenberg u takua me Presidentin Joe Biden në Shtëpinë e Bardhë për të diskutuar forcimin e mëtejshëm të lidhjes transatlantike si dhe përgatitjet për Samitin e NATO-s në Madrid vitin e ardhshëm. Ai gjithashtu u takua me Sekretarin e Mbrojtjes Lloyd Austin, Këshilltarin për Sigurinë Kombëtare Jake Sullivan dhe foli me Sekretarin e Shtetit Anthony Blinken në telefon.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se Aleanca vazhdon të përshtatet në një botë më të paparashikueshme, ku konkurrenca e fuqive të mëdha po rritet, së bashku me kërcënimet kibernetike, terrorizmin dhe ndikimin e sigurisë të ndryshimeve klimatike. Ai theksoi se aleatët po investojnë më shumë në mbrojtje. 2021 është viti i shtatë radhazi i rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes tek aleatët evropianë dhe Kanadaja, me 260 miliardë dollarë më shumë për mbrojtjen e investuar që nga viti 2014. Diskutimet u drejtuan edhe Afganistanit. Z. Stoltenberg tha se aleatët kishin marrë vendimin për t'u larguar së bashku pas shumë raundesh konsultimesh. Ai theksoi se misioni nuk ishte i kotë, pasi për 20 vjet, asnjë sulm terrorist nuk është nisur mbi vendet e NATO-s nga Afganistani. Aleatët e NATO-s vazhdojnë të punojnë së bashku për të siguruar që vendi të mos bëhet përsëri një strehë e sigurt për terroristët. Ai arriti në përfundimin se vendimi i vështirë për Afganistanin nuk ndryshon nevojën që Evropa dhe Amerika e Veriut të qëndrojnë së bashku në NATO.

Më 5 tetor 2021, Sekretari i Përgjithshëm u takua me ligjvënësit në Capitol Hill dhe mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Instituti Brookings dhe Universiteti Georgetown, i titulluar "NATO në një botë konkurruese".

Fuqia e NATO-s vjen nga fuqia e saj ushtarake, uniteti, ndjenja dhe qëllimi i përbashkët

Z. Stoltenberg gjatë vizitës së tij në Uashington DC u takua me Sekretarin e Mbrojtjes Lloyd Austin dhe Këshilltarin e Sigurisë Kombëtare Jake Sullivan në Pentagon. Në takim në Pentagon Sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III, falënderoi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s në krye të Aleancës dhe për vizionin e tij strategjik për të ardhmen, "për udhëheqjen tuaj të vazhdueshme dhe për përpjekjet tuaja ambicioze për të forcuar Aleancën për të ardhmen". Sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III theksoi se "Fuqia e NATO-s vjen jo vetëm nga fuqia e saj ushtarake, por nga uniteti dhe ndjenja e qëllimit të përbashkët. Ju keni qenë një kampion i shquar i atyre pikave të forta dhe ne do ta mbajmë këtë Aleancë elastike, të vendosur dhe të bashkuar", deklaroi Sekretari Austin. Ai theksoi se ata kishin punuar "së bashku gjatë përfundimit të misionit tonë ushtarak në Afganistan" dhe falënderoi z. Stoltenberg, në emër të Shteteve të Bashkuara, për rolin thelbësor gjatë tërheqjes dhe evakuimit. "NATO hyri në Afganistan si një Aleancë e bashkuar pasi thirri nënin 5 pas 11 Shtatorit, dhe 20 vjet më vonë, NATO u largua nga Afganistani si një Aleancë e unifikuar, falë pjesës më të madhe të përkushtimit tuaj", nënvizoi



Sekretari amerikan i Mbrojtjes. Duke vlerësuar Samitin NATO-s në qershor, "të suksesshëm", Sekretari Austin përmendi "agjendën e NATO 2030", të iniciuar nga Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, si një qasje për dekadën e ardhshme dhe sfidat në zhvillim. "Udhëheqësit aleatë filluan një sërë nismash të guximshme për të siguruar që NATO të vazhdojë të ofrojë siguri për të gjithë qytetarët tanë deri në vitin 2030 dhe më gjerë. Ne kemi nevojë për investime të vazhdueshme në parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s, si dhe një koncept strategjik të rishikuar që do të udhëheqë qasjen e Aleancës ndaj mjedisit strategjik në zhvillim. Pra, kemi shumë për të bërë dhe mezi pres të punoj në këto përpjekje me ju dhe kolegët e mi të mbrojtjes në Ministerialin tonë të NATO-s më vonë këtë muaj". NATO, tha ai, mbetet "forumi thelbësor për konsultime, vendime dhe veprime mbi çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes transatlantike, dhe NATO është një bazë mbi të cilën ne vazhdojmë të ndërtojmë sigurinë tonë kolektive dhe prosperitetin e përbashkët. Është Aleanca më e fuqishme dhe e suksesshme në histori dhe ne do ta mbajmë atë në atë mënyrë", deklaroi Sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha në fjalën e tij gjatë takimit se "është mirë të kthehesh në Pentagon" dhe falënderoi Sekretarin e Mbrojtjes Austin për pritjen e ngrohtë "por "më e rëndësishmja" për angazhimin e fortë ndaj NATO-s, "për udhëheqjen tuaj", tha Stoltenberg dhe vlerësoi Forcat e Armatosura të Amerikës. "Më lejoni gjithashtu të nderoj të gjithë burrat dhe gratë në Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara, të cilët, çdo ditë, punojnë për sigurinë tonë të përbashkët dhe janë pjesë e angazhimit të përbashkët që kemi në NATO". NATO është "po aq e rëndësishme sa kurrë sepse ne përballemi me një botë më konkurruese", tha Stoltenberg. "Ne e shohim Rusinë përgjegjëse për veprimet agresive, ne shohim një Kinë më pohuese që përdor fuqinë e saj ekonomike dhe ushtarake, dhe ne gjithashtu përballemi me kërcënime kibernetike, kërcënime të vazhdueshme

terroriste dhe gjithashtu ndikimi i sigurisë nga ndryshimet klimatike. Pra nuk ka asnjë kontinent, asnjë vend që mund të përballë vetëm me këtë sfidë".

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, theksoi rëndësinë e Aleancës, dhe nuk la pa përmendur rëndësinë e investimeve në Mbrojtje, që nga vendimi i vitit 2014. "Ne duhet të qëndrojmë së bashku, Amerika e Veriut dhe Evropa, në NATO, dhe ne duhet të përshtatim Aleancën me ndryshimin e mjedisit të sigurisë dhe kjo është pikërisht ajo që ne po bëjmë. Që kur morëm vendimin në vitin 2014, të gjithë aleatët kanë investuar më shumë në mbrojtje, aleatët evropianë dhe Kanadaja kanë shtuar 260 miliardë dollarë shtesë për mbrojtjen gjatë këtyre viteve, dhe gjithnjë e më shumë aleatë gjithashtu përbushin shpenzimet e detyrimit në dy përqind të PBB -së për mbrojtjen. Kështu që NATO po përshtatet, duke iu përgjigjur një mjedisi më kërkues të sigurisë, dhe ne kemi nevojë ta ruajmë këtë vrull ndërsa ecim përpara", tha ai.

Lidhur me Afganistanin dhe përfundimin e misionit 20 vjeçar, Stoltenberg tha se misioni i NATO-s nuk ishte i kotë. "Ne qëndruam së bashku në Afganistan për 20 vjet. Ishte një vendim i vështirë për t'u larguar nga Afganistani, por ishte një vendim që e morëm së bashku, si 30 aleatë. Pas konsultimeve të gjera, disa takimeve ministrore dhe shumë konsultimeve diplomatike në Shtabin e NATO-s midis aleatëve, ne morëm vendimin së bashku për t'i dhënë fund pranisë sonë ushtarake atje. Misioni ynë në Afganistan nuk ishte i kotë. Për 20 vjet, ne parandaluam çdo sulm terrorist që organizohej nga Afganistani kundër vendeve tona dhe ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku për të siguruar që ne të ruajmë fitimin e arritur në luftën kundër terrorizmit. Ne do të vazhdojmë të modernizojmë Aleancën, për të demonstruar se jemi më të fortë kur qëndrojmë së bashku, dhe për mua, kjo, është e qartë se kriza në Afganistan nuk ndryshon mesazhin kryesor, nuk ndryshon nevojën për Evropën dhe Veriun Amerika të qëndrojnë së bashku e fortë në NATO.

NATO në një botë konkurruese

Duke folur në aktivitetin e organizuar nga Instituti Brookings dhe Universiteti Georgetown në Uashington DC, më 5 tetor 2021, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se Nevoja për unitet transatlantik është sot më e madhe se në çdo kohë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. "Herën e fundit që folam me Brookings, NATO po përgatitej për Samitin tonë, të cilin e zhvilluam në qershor të këtij viti. Ai ishte një Samit i suksesshëm, duke hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet transatlantike midis Amerikës së Veriut dhe Evropës", tha Stoltenberg.

"Sidoqoftë, po bëhen pyetje në lidhje me forcën e lidhjes midis Evropës dhe Amerikës së Veriut. Mbi marrëveshjen AUKUS midis Australisë, Britanisë së Madhe dhe SHBA-së dhe mbi tërheqjen tonë nga Afganistani. Ne gjithmonë duhet t'i marrim seriozisht dallimet tona dhe t'i trajtojmë ato. Por ato nuk ndryshojnë tablonë e madhe: Rëndësia e Evropës dhe Amerikës së Veriut që qëndrojnë së bashku në NATO. Në fakt, nevoja për unitet transatlantik është më e madhe sot se në çdo kohë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Sepse ne jemi në një moment kryesor për sigurinë tonë të përbashkët. Aty ku përballemi me një botë më të rrezikshme dhe më konkurruese. Rusia është më agresive jastë vendit dhe më shtypëse në vend. Kina po përdor fuqinë e saj ekonomike dhe ushtarake, për të kontrolluar njerëzit e vet, detyrojë vendet e tjera dhe të kontrollojë zinxhirët global të furnizimit, infrastrukturën kritike dhe asetet e tjera", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. "Ne gjithashtu përballemi me sulme kibernetike më të shpeshta dhe më të sofistikuar. Kërcënimet e vazhdueshme terroriste dhe ndikimet e sigurisë të ndryshimit të klimës. Askush nga ne nuk mund të përballë vetëm me këto sfida. Asnjë vend, sado i madh dhe asnjë kontinent, sado i pasur. As SHBA, as Evropa vetëm. Por në NATO nuk jemi vetëm. Së bashku ne përfaqësojmë 30 kombe të ndryshme, një miliard njerëz, gjysma e fuqisë ekonomike dhe ushtarake të botës. Dhe së bashku ne po përshtatemi

me një botë më të pasigurt", nënvizoi Jens Stoltenberg fuqinë dhe potencialin e NATO-s dhe përshtatjen e Aleancës. "Në fakt, Aleanca jonë është në mes të një ndryshimi themelor. Kjo filloi në vitin 2014, në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia. Ne po i zhvendosim përpjekjet dhe burimet tona nga operacionet e mëdha luftarake jashtë territorit të NATO-s. Për të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen tonë në vend dhe përgatitemi për një botë të një rivaliteti më të madh shtetëror.", tha ai. Sekretari i Përgjithshëm tha se të gjithë aleatët kanë rritur shpenzimet e mbrojtjes, kanë investuar në aftësi të nivelit të lartë dhe kanë rritur gatishmërinë e forcave. "Ne i kemi shtuar shterëvizet dhe aktivitetet tona, në tokë, në det dhe në ajër. Trupat shumëkombëshe të gatshme për luftime u vendosën në rajonin e Baltikut dhe forcuam mbrojtjen tonë kundër sulmeve kibernetike dhe hibride. Në Samitin tonë në qershor, ne ramë dakord të bëjmë edhe më shumë së bashku për të modernizuar dhe përshtatur Aleancën tonë, për të përcaktuar kursin tonë për dekadën e ardhshme dhe më gjerë.". Ai tha se ndërsa NATO vazhdon të rrisë gatishmërinë ushtarake "për t'iu përgjigjur kërcënimeve nga çdo drejtim, ne jemi gjithashtu duke e mprehur avantazhin tonë teknologjik duke lansuar një nxitës të ri të inovacionit të mbrojtjes dhe fondin e inovacionit, për të mbështetur industrinë, bizneset e reja dhe akademikët që punojnë në teknologjitë e fundit". Aleanca tha ai po forcon mbrojtjen kibernetike dhe po rrit elasticitetin e "infrastrukturës sonë kritike dhe zinxhirëve të furnizimit për të zvogëluar dobësitë tona. Ne po rritemi për të mbrojtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke thelluar bashkëpunimin tonë me vendet dhe organizatat me mendje të njëjtë, përfshirë në rajonin e Azi-Paqësorit."

Stoltenberg tha se NATO "për herë të parë", po i vendos ndryshimet klimatike dhe sigurinë në thelbin e axhendës së saj. "Ndryshimet klimatike nxisin dhe shumfishojnë rrezikun e konfliktit dhe kërcënojnë sigurinë tonë dhe ndikojnë në mjedisin në të cilin ne veprojmë. Kështu që NATO duhet të luajë rolin e saj", tha ai. "Ne po i përshtatim planifikimet, instalimet dhe pajisjet tona në mot më ekstrem dhe krijimin e metodologjisë së parë ndonjëherë për të hartuar emetimet ushtarake në të gjithë Aleancën. Kështu edhe ne që mund të kontribuojmë në qëllimin e emetimeve Neto Zero. Marrë së bashku, kjo zhvendosje drejt parandalimit dhe mbrojtjes në vend dhe modernizimi i NATO-s do të kontribuojë drejtpërdrejt në sigurinë tonë të përbashkët. Ne nuk e dimë se cila do të jetë kriza e radhës. Por ne e dimë se çfarëdo që të ndodhë, ne jemi më të sigurt kur qëndrojmë së bashku. Evropa dhe Amerika e Veriut kanë qëndruar të fortë në NATO për më shumë se 70 vjet dhe ne duhet të vazhdojmë të qëndrojmë të fortë së bashku për t'u përballur me një botë më konkurruese. Kjo është e mirë për Evropën dhe është mirë për Amerikën e Veriut. ", tha Jens Stoltenberg.

Psikologjia njerëzore në kushtet e aktivitetit ushtarak

‘Jo vetëm muskuj, stërvitje e ashpër dhe kurajo. Luftrat tani fitohen edhe me forcën e psikologjisë dhe një mendje të mësuar të mendojë pozitivisht’

Edukimi moralo-psikologjik

Mbështetur në përvojën e luftërave, mendimi ushtarak e ka vlerësuar faktorin moral si parësor, sepse kur lidhet drejt me faktorët e tjerë materialë, teknikë e ushtarakë, ai përmbys vlerësime e raporte të ndryshme forcash. Në të kundërt, kur morali vlerësohet nga pozita burokratike në mënyrë të njëanshme, si qëllim në vetvete, i idealizuar e i politizuar, në situata luftarake si vështirësia, po ashtu dhe pengesa më e vogël e komprometon përmbajtjen e tij, krijon zbrazëti shpirtërore e krizë që të çojnë drejt katastrofës. Parë në këtë prizëm, përgatitja moralo-psikologjike është e pandashme nga ajo ushtarake, nga aspekti komandues e drejtues. Edukimi moralo-psikologjik, që bëhej në mënyrë dogmatike në ushtri, në kohën e monizmit solli në shumë raste një shkëputje të tij nga faktorët ushtarakë. Absolutizimi i moralit dhe glorifikimi i tij sollën moralizime të pafund, skema, formalizëm dhe eufori. Të ashtuquajturat “gjendje e lartë moralo-politike”, “uniteti i çeliktë”, “bindje e besim absolut në drejtësinë e çështjes” etj., jo vetëm ishin pjellë e dukurive të mësipërme, por edhe u kthyen në një kod moral të mërzitshëm e pa jetë, që shoqëronte të gjithë jetën në ushtri. Ndikimi i faktorëve materialë e ushtarak, sidomos në luftë, ndaj faktorëve moralë

Luftrat I fitojnë njerëzit dhe jo armët

Mesazhi i historisë së luftërave nga ato primitive e deri tek ato moderne është se, ato gjithmonë i kanë fituar njerëzit dhe jo armët. Kushdo që e ka harruar këtë, shpejt ose vonë, është detyruar ta kujtojë. “Një divizion me gjendje të lartë morale, thekson Klauzeviçi, mund të zëvendësojë së paku tre divizione që nuk e kanë këtë cilësi. Morali i lartë është forcë lëvizëse me rëndësi përcaktuese, armë gjithmonë e re e në veprim, mjeti për të fituar luftën apo për të shndërruar disfatën në fitore”¹. Cilado ushtri qoftë nuk mund të quhet e shkatërruar, përderisa nuk përshkohet nga ndjenja e disfatës, sepse disfata është përfundim i arsyes dhe jo një gjendje fizike. Në të vërtetë popujt, ushtritë, kombet për sa kohë që tek ata ka ekzistuar vullneti, vendosmëria, idealet e aspiratat për të mos iu nënshtruar asnjë lloj pushtimi, dhune fizike e morale, nuk janë mposhtur, qoftë dhe në situata më të rënda, ata kanë ditur të luftojnë, janë organizuar, kanë gjetur forma e metoda lufte origjinale, duke iu kundërvënë me sukses armikut.

Psikologjia ushtarake (shkenca e sjelljes)

Këto çështje përfshijnë përgjeshjen dhe klasifikimin e person-



elit ushtarak; procesit të mësuarit, teknologjisë ushtarake dhe armës në zotërim; karakteristikat individuale psikologjike të nevojshme për aktivitetet ushtarake; luftën psikologjike. Problemi themelor i psikologëve ushtarake dhe studiuesve të përfshirë në proces nuk është shumë e ndryshme nga përmbajtja e degëve të tjera të psikologjisë të përfshira, dallimi është vetëm se studimi është kryer në një mjedis ushtarak, zbatimin e objekteve ushtarake. Për këtë arsye, ajo gjithashtu përmban disa nga fushat tradicionale të hulumtimit psikologjik, kryesisht Psikologji Personelit (në lidhje me personelin në përgjeshjen, klasifikimit, emërimet), psikologjisë së të mësuarit (trajnime), psikologjisë eksperimentale, faktorët e njeriut hulumtim, psikologjisë sociale, psikologji klinike dhe psikologjia organizative. Sipas karakteristikave të armëve, psikologjia ushtarake mund të ndahet në hapësirën ajrore, detare dhe tokësore.

Psikologjia Ushtarake është zhvilluar e diferencuara nga psikologjia e profileve të tjera. JE Wu Lanna (1977) beson se diferencimi i saj filloi 6 prill 1917 në takimin Shoqata Psikologjike Amerikane. Në atë kohë, Shtetet e Bashkuara kanë qenë të përfshira në Luftën e Parë Botërore, në funksion të situatës, disa nga pjesëmarrësit e ngritën çështjen e psikologut eksperimental si mjaft të rëndësishëm në shërbimet e mbrojtjes. Takimi do të diskutonte historinë dhe studimin e psikologjisë ushtarake në fillim të supozuar. Aktualisht, shumë vende kanë institutin e këshillimit psikologjik ushtarak.

Kuptim

Fjala psikologji vjen nga greqishtja,

që do të thotë shkenca e shpirtit. Soul në greqisht do të thotë gjithashtu të marrë frymë gaz apo për shkak se njerëzit e lashtë mendojnë se jeta është e varur në frymëmarrje, arrest respirator, jeta është e gjatë. Me zhvillimin e shkencës, objekti psikologjisë nga shpirti në shpirt. Deri në fillim të shekullit të 19-të, filozofi gjerman, edukatori Herbart propozoi psikologjinë si shkencë origjinale, psikologji, pedagogji të dyja i përkasin të njëjtës kategori të filozofisë, dhe më vonë të ndarë nga fillimet e tyre filozofike.

Psikologjia është studimi i fenomenit psikologjik të njerëzve dhe kafshëve, funksioni shkencor I mendjes dhe sjelljes, si një disiplinë teorike, por edhe në zbatimin e disiplinës.

Hulumtimet psikologjike përf-

shijnë, perceptimin, njohjen, shumë fusha të emocioneve, personalitetin, sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale, por edhe me shumë fusha të jetës së përditshme - familjen, arsimimin, shëndetësinë dhe shfaqje të tjera të ngjashme. Psikologjia në njërin anë përpiket të shpjegojë funksionimin e sjelljes dhe atij mendor, njëkohësisht përpiket të shpjegojë psikologjinë e rolit personal, funksionimin psikologjik në sjelljen sociale dhe dinamikat sociale të shoqërisë, ndërsa ajo është e lidhur edhe me Neuroscience.

Provë

Në Luftën e Parë Botërore, në mënyrë që të përgjigjeshin një numër i madh ushtarësh për të plotësuar nevojat e luftës shpejt të klasifikuar, u

zhvillua modeli testi I grupi. Pas Luftës së Parë Botërore, kur një lloj testimi ushtarakësh si ai i (testimit të klasifikimit të nivelit arsimor) dhe testi B ushtrisë ‘Class’ (për ushtarët analfabet dhe jo-anglisht folës) kur përdoret në fusha jo-ushtarake, u realizua si model i testeve të zbulimit të grupit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për forcat ushtarake u realizua testi I klasifikimit të përgjithshëm (AGCT). Ndërkohë, për shumë nga nevojat e veçanta të një përgatitje të veçantë testi ishte ai i pilotit bombardues, radio operator dhe teste të tjera të përgjeshjes. Pastaj “Office kundërmasat” (OSS) ka përgatitur edhe seri veprimesh të përdorura në lloje të ndryshme të përgjeshjes operator, test me letër të zakonshme, stilolaps proces testimi nga ana tjetër, është paraardhësi i vlerësimeve të mëdha moderne.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera për të studiuar teste ushtarake nuk e ndërprejnë ‘operacionin e tyre’. Në Shtetet e Bashkuara, testi kualifikimi ushtarak (AFQT) zëvendësoi testin e mëparshëm atë të kualifikimit të përgjithshëm (AGCT). Puna në ushtri, përveçse studion tendencat psikologjike dhe testet e interesit, studion karakteristikat e një shumëllojshmëri të kapaciteteve njerëzore të nevojshme për punën ushtarake. Në disa punë të veçantë ushtarak, trupi është aktiviteti primar, kështu që kur aplikanti rekrutohet renditen femra, e rëndësishme analiza e nevojave fizike.





Stërvitje

Marrëdhëniet, trajnimi dhe testimi janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme. Sepse sistemi kryesor i trajnimit është gatishmëria në punë.

Përmbajtja

Trajnimi përfshin një varietet të nevojave të veçanta ushtarake operative, duke simuluar mjedisin aktual të luftës për të mësuar dhe për të zotëruar “, pajisje të ndryshme dhe situata (të tilla si mjet ajror apo marrjen e vendimeve luftë).

Përmbajtja e tyre kryesore janë: diagnoza të sjelljes psikologjike, individët, grupet e korrigjimit, sjellja e vlerësimit të personelit ushtarak, vlerësimi individual, operacionet ushtarake të lidhura me mësimdhënie dhe kërkime, dhe lloje të tjera të veçanta të punës.

Faktorët e Njeriut

Faktori njerëzor është marrëdhënia në mes njeriut dhe makinës në shumëllojshmëri të detyrave të mjedisit. Në shumë nga këto marrëdhënie, rezultatet përfundimtare të studimit të të gjithë sistemit operativ janë pjesa më e rëndësishme. Për shkak të projektimit dhe funksionimit të pajisjeve dhe sistemit efikas të trajnimit, duhet të ketë një proces të përmirësimit të vazhdueshëm. Procesi themelor i studimit përfshin: përgjigjet fiziologjike të njerëzve për shkak të auditorit.

Klinik

Përveç psikologëve ushtarakë në modifikimin e sjelljes janë shkencëtarët dhe neurologët që punojnë ngushtë për të studiuar stresin dhe probleme të tjera të veçanta klinike.

Ka shumë studime të tjera që përfshijnë shndërrimin ideologjik, procesin e gjykimit

dhe të privimit ndijor. Këto probleme origjinën e kanë në Luftën e Vietnamit, të Koresë, disa raste të veçanta, hulumtimi është i dominuar nga disa studiues të SHBA-së, Britania e Madhe dhe Kanada. Këto raporte paraqiten në “luftë psikologjike si një libër, përmbajtja kryesore e studimit të tij ishte efekti i reagimeve psikologjike të izolimit të rreptë, të tilla si në “përmbledhje nëndetëse të punës,” një libër studimi i punës së nëndetëseve. Ka disa studime për çështje të familjes në luftë, kryesisht anëtarët e familjes për shkak të efekteve psikologjike të problemit të shkaktuar nga ndarja e të afërmeve, dhe marrëdhëniet familjare për të shtyrë periudhën e shërbimit të ndikimit të qëndrimit.

Psikologjia ushtarake

Psikologët ushtarakë kanë studiuar çështjen e udhëheqjes. Fokusi kryesor i hulumtimit është në kreun e fundit të përzgjedhjes, trajnimit dhe vlerësimit në aspektet e zhvillimit të çështjeve aktuale kërkimore nga e kaluara në studimin e faktorëve të mjedisit, si dhe zhvillimin organizativ.

Teknologjia ka qenë në ushtrinë amerikane për të filluar aplikimin, qëllimi i tij është të forcojë organizimin dhe efikasitetin. Kjo kërkon përdorimin e zonave jo-ushtarake të teknologjisë

Rezultatet e psikologëve në procedurat e informacionit, të drejtimit dhe mësimdhënies parashikuara për zhvillimin e vendimit të luftës është i bazuar në të dhënat të përgjithshme. Ndërkohë, me zhvillimin e shkencës moderne, aplikimet kompjuterike, hulumtimet në

vendimmarrje ushtarake janë gjithashtu një fazën moderne.

Femrat, armata e fuqishme në kohë lufte dhe paqe

Gjatë tre dekadave të fundit, psikologët kanë qenë të dobishëm në përpjekjet për të përmirësuar ushtrinë dhe për të rritur efektivitetin e saj. Në 1980, gratë ishin ende të ndaluara nga të gjitha punët e drejtpërdrejta luftarake në ushtri, dhe ishin të përfaqësuara në vetëm një numër të vogël në punë jo-luftarake. Klasa e parë e grave u diplomua në akademitë e shërbimit kombëtar. Gratë kanë shërbyer me guxim dhe në luftime në Irak dhe Afganistan. Mbi 20 përqind e kadetëve në West Point, Akademinë Detare dhe Akademinë e Forcave Ajrore janë tani gra, dhe këto numra ka të

ngjarë të rriten në vitet që vijnë. Si Komandanti ashtu edhe Dekani në West Point janë drejtuar nga gratë. Shumë të tjerë janë ngritur në gradën e oficerit të përgjithshëm. Dhe gjatë gjithë rrugës, psikologët kanë lehtësuar këto përparime duke kryer hulumtime që shpërndajnë pikëpamjet e paragjykuara gjinore të kompetencës ushtarake, dhe si avokate të zëshme për të drejtat e grave për t'i shërbyer kombit të tyre në të njëjtat kapacitete, dhe me të njëjtat përgjegjësi, si burra. Kjo kohët e fundit çon në eliminimin e rregullit të përjashtimit të luftimit dhe hapjen e të gjitha vendeve të punës ushtarake për gratë duke përfshirë të drejtën për trajnim elitare ushtarak.

Barrazia gjinore kusht zhvillimi

Çdo shtet për të arritur misionin e tij, në përbërjen e ushtrisë së ardhshme duhet të pasqyrojë përbërjen e popullsisë, si dhe të jetë gjithëpërfshirëse për gratë, njerëzit me orientime të ndryshme seksuale dhe personat transgjinorë. Sepse një ushtri e larmishme do të përfshijë ekspertë kulturorë “të rritur në shtëpi”, të cilët mund të ndihmojnë të kuptohet dimensionin socio-kulturor i luftërave të ardhshme. Psikologët, janë lojtarët kryesorë për të ndihmuar ushtrinë të modernizojë praktikat e saj të rekrutimit, dhe për të ndihmuar zhvillimin e praktikave organizative dhe kulturës pozitive për të ndihmuar ushtrinë në shfrytëzimin e plotë të larmisë së forcës së ardhshme.

Psikologjia shkolla inovative e njerëzve nën armë

Më shumë se 15 vjet luftë kanë stresuar ushtrinë. Shkalla e vetëvrasjeve është ngritur në qiell. Çrregullimet e lidhura me stresin janë të shfrenuara midis veteranëve të luftës. Për shkak të protokolleve mjekësore të përmirësuar dhe mjeteve mbrojtëse, shumë ushtarë mbijetojnë nga plagët që do t'i kishin vrarë në luftërat e kaluara, vetëm për të përjetuar efektet afatgjata të dëmtimit traumatik të trurit ose amputimit të ekstremiteteve. Puna e psikologëve klinikë ushtarakë është thelbësore për zhvillimin e mënyrave inovative dhe efektive për të ndihmuar ushtarët e plagosur fizikisht dhe psikologjikisht të kapërcejnë dëmtimet e tyre.

Psikologjia është bërë e rëndësishme për ushtrinë në shekullin 21, nga mënyrat e shumta që psikologët tani kontribuojnë në mbrojtjen e kombit. Ka shumë më tepër. Teknologjia, në formën e avionëve me performancë të lartë, anijeve të fshehta, armëve precize, e kështu me radhë janë komponentët e nevojshëm për forcën ushtarake. Por këto sisteme, sado të përparuar të jenë, në fund të fundit janë në duart e qenieve njerëzore. Kështu, psikologjia do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në zgjerimin e ushtrisë.

Punoi: Anjeza MUSOLLARI
Referuar: Carrie.H.KENNEDY
Nënkolonel; Ajet NUELARI



Çfarë presin ekspertët dhe politika në Gjermani?

Samiti BE-Balkan Perëndimor në Brdo pri Kranju, Slloveni, synon të ruajë perspektivën europiane të këtij rajoni

Gjermania është një nga vendet që e mbështet perspektivën e Ballkanit Perëndimor në BE. Ministri i jashtëm Heiko Maas, ka apeluar në kuadër të një takimi me homologun e tij nga Maqedonia e Veriut, Bujar Osmani për çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, përkatësisht fillimin e konferencës së parë ndërqeveritare. Ky proces për momentin ka ngecur, për shkak të vetos bullgare. Maas tha se Samiti i BE-së me Ballkanin Perëndimor në Brdo pri Kranju duhet të “dërgojë në rajon mesazhin e qartë se anëtarësimi i shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE është një synim i arritshëm”.

Ekonomia gjermane

gati për çelje të negociatave

Edhe kryetari i Shoqatës së Bizneseve në Lindje, Oliver Hermes, sipas një deklaratë të publikuar në prag të samitit ka kërkuar nga qeveria gjermane të loboje për çeljen zyrtar të negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, siç del në pah nga një dokument pozicionimi që nga ka nxjerrë në prag të samitit Shoqata e Bizneseve të Lindjes. “Presim nga qeveria e re që të vijojë angazhimin e deritanishëm dhe të investohet me vendosmëri në Bruksel për çeljen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, çfarë është miratuar qysh vitin e kaluar”, the Hermes.

Shkëmbimi i mallrave të Gjermanisë me rajonin është trefishuar në periudhën 2009 më shumë se dymbëdhjetë miliardë euro. Kompanitë gjermane kanë kryer investime në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, e sidomos në Serbi, ku numri i vendeve të punës të hapura falë investimeve gjermane ka arritur në 70.000, e në Bosnjë dhe Hercegovinë rreth 35 000 vende pune.



Një shifër e ngjashme synohet të arrihet edhe në Maqedoninë e Veriut. Agora Energiewende, me qendër në Berlin, bën thirrje që në kuadër të axhendës së

gjelbër, që është pjesë e Planit Ekonomik dhe Investitor të BE-së, të dilet nga përfitimi i ekonomisë nëpërmjet qymyrit. Në një studim të publikuar në prag të

samitit, Agorawende thotë se dy minierat e qymyrit që janë planifikuar të ndërtohen në rajon janë destinuar të dalin me humbje. Kjo, pasi vetë nxjerrja e qymyrit

është shumë kushtueshme, por edhe për shkak të rritjes së masave që duhen marrë për mbajtjen e ajrit të pastër, si edhe për faktin që do të vështirësohet shitja e energjisë së fituar prej qymyri në Evropë. Agora Energiewende kërkon që të fillohet që tani me kalimin në energji të ripërtërishtme e cila sipas saj është e mundur te realizohet deri në vitin 2040.

“Por a do të sjellë rritje plani ekonomik?”

Por një studim i përbashkët i Fondacionit gjerman Bertelsmann dhe Instituti Vjenez për Ekonomi të Krahasuar, publikuar në prag të samitit, e kritikon këtë strategji. Autorët Stefani Weiss dhe Richard Grieveson janë të mendimit se pakoja ekonomike e BE-së nuk do ta ndryshojë gjendjen e trishtë ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Dhe se investime të tilla edhe në të kaluarën nuk kanë funksionuar. Rritja e këmbimit tregtar brenda rajonit nuk e ka rritur mirëqenien për kokë të popullsisë së rajonit, i cili është ende 15 deri 20 herë më i ulët se ai i BE-së. Ata propozojnë integrimin ekonomik të rajonit me BE-në, duke hapur fondet strukturore dhe të kohezionit si edhe instrumente të tjera të financiare.

Mario Draghi, Olaf Scholz, Emmanuel Macron kush mund të zëvendësojë udhëheqësen e kontinentit Angela Merkel

Angela Merkel e dominoi Europën. Ajo ishte de facto një udhëheqëse e kontinentit në një periudhë krize. Për 16 vite me radhë Merkel e ka përdorur pragmatizmin e saj të kujdesshëm dhe të qetë, për të drejtuar kontinentin në kohën e ngritjes të së djathtës ekstreme, gjatë një përgjigje të gabuar ndaj krizës së emigrantëve, dhe natyrisht Brexit. Me mbylljen e epokës Merkel, vendin e saj mund ta zërë një udhëheqës tjetër evropian. Ja cilët janë 3 pretendentët kryesorë

Mario Draghi

Një nga vlerësimet më të mëdha të udhëheqjes së Mario Draghi erdhi nga kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez, gjatë një vizite që zhvilloi në qershor në Romë. Duke e përshkruar si një “maestro” ish-shefin e Bankës Qendrore Evropiane, Sanchez tha: “Sa herë që Draghi flet në Këshillin Europian, ne të gjithë heshtim dhe e dëgjojmë. Dhe kjo nuk është diçka që ndodh shpesh

Draghi, i emëruar kryeministër i Italisë në shkurt të këtij viti, ka pasur një ndikim të ngjashëm në grupin e partive politike që përbëjnë koalicionin e tij të gjerë, ku secila ka kontestimet e veta mbi një sërë çështjesh të vështira, përfshirë futjen në përdorim të pasaportës së vak-

sinës anti-Covid.

Po ashtu Draghi i ka bërë përshtypje elektoratit italian, duke rezultuar aktualisht në sondazhe si udhëheqësi më i vlerësuar në vend. Pra shumë larg asaj me të cilën janë mësuar italianët. Qeveria Draghi pati sukses me programin e vaksinimit ndaj Covid-19, ka ringjallur ekonominë italiane, dhe ka ndërmarrë masa të zbatueshme për të kontrolluar infeksionet e reja me koronavirus.

Për më tepër, Draghi ia ka dalë të çojë përpara një reformë të kontestuar në sistemin e drejtësisë, një kusht ky që duhet të plotësojë Italia që të sigurojë pjesën më të madhe të fondit të rimëkëmbjes nga pandemia të dhënë nga Bashkimi Evropian.

“Gjërat duhet të bëhen pasi kështu duhet, dhe jo që të kemi një rezultat të menjëhershëm, edhe nëse ato janë jopopullore”- deklaroi Draghi gjatë muajit të kaluar. Pragmatik, i qetë, vendimtar dhe pa drojë për t’i thënë gjërat ashtu siç janë, për disa nga njerëzit që punojnë me të, Draghi, i respektuar jashtë vendit po aq sa edhe në shtëpi, është kandidati më i fortë për të zënë vendin e Merkelit si udhëheqësi de fakto i Evropës. “Ne kemi figurën më të spikatur, dhe ai është Mario Draghi”, deklaroi Giancarlo

Giorgetti, Ministri italian i Zhvillimit Ekonomik.

Olaf Scholz

Politika evropiane nuk luajti gati asnjë rol në fushatën zgjedhore në Gjermani. Kjo ndoshta ka të bëjë më shumë me faktin se përkundër dallimeve në politikat midis partive, që tani po negociojnë për një pozicion në qeverinë post-Merkel, në Evropë çdo parti kryesore është pak a shumë në të njëjtën qasje: Gjermania ka nevojë për BE, më shumë sesa BE-ja ka nevojë për Gjermaninë.

Nëse Scholz do të ketë sukses në krijimin e një qeverie të koalicionit dhe bëhet kancelar, nuk ka shumë të ngjarë që të ndryshojë mënyrën e qeverisjes. Roli i tij si Ministër i Financave nën qeverinë Merkel – përgjegjës për menaxhimin e ekonomisë – dhe kontributi i tij qendror në krijimin e fondit të BE-së për rimëkëmbjen nga koronavirusi prej 750 miliardë eurosh, e përforcoi angazhimin e tij ndaj bllokut.

Ai e quajti fondin “një sinjal të qartë për solidaritetin dhe forcën e Evropës”, teksa në të njëjtën kohë i dërgoi mesazh gjermanëve se një rimëkëmbje e fuqishme në Evropë, ishte një parakusht thelbësor.

Merkel e Macron bëjnë bashkë Zaeu dhe Radev

Nepermjet njoftim të ambasadës bullgare, udhëheqësit evropiane organizuan 2 takime midis presidentit të Bullgarisë Rumen Radev dhe kryeministrit të Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev brenda pak orësh në Brdo.

Radev u ftua të marrë pjesë në takimin e parë të përbashkët me Zaevin me Komisionerin Evropian për Fqinjësinë dhe Zgjerimin Oliver Varhelyi dhe Kryeministrin Slloven Janez Janša, menjëherë pas këtij takimi Radev dhe Zaev u ftuan nga kancelarja gjermane Angela Merkel në një bashkëbisedim të përbashkët me presidentin francez Emmanuel Macron.

Kjo është pjesë e presionit ndaj Bullgarisë për të hequr veton e saj mbi bisedimet e anëtarësimit të Shkupit. Udhëheqësit evropianë janë të vetëdijshëm se nuk ka asnjë mënyrë për të ndryshuar qëndrimin e Sofjes para zgjedhjeve të 14 nëntorit. Takimet e tyre mund të interpretohen si inkurajim i Radev për të ndihmuar në proces pas formimit të mundshëm të një qeverie të qëndrueshme në Bullgari në fund të nëntorit.

Siç pritej, Bullgaria ka njoftuar se nuk mund të pritet një përparim në Brdo.

“Nuk ka asnjë arsye për të ndryshuar qëndrimin e Bullgarisë ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut (QRM), pavarësisht presionit serioz që vendi ynë do t’i nënshtrohet nga partnerët e tij evropianë në samitin BE-Balkanin Perëndimor,” tha nënpresidentja bullgare Iliana Iotova.

Ajo shpjegoi se qëndrimi bullgar ka për qëllim respektimin e të drejtave të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut me identitet bullgar.

“Rezultatet e regjistrimit të popullsisë në Maqedoni, i cili po zhvillohet në RCM, do të jenë shumë të rëndësishme. Shumë sinjale alarmante po na vijnë. Shkatërrimi i pllakave përkujtimore ka filluar përsëri”, tha Zëvendëspresidentja.

Qeveritë kujdestare të Radev kanë mbajtur linjën e tërhequr nga qeveria GERB në bisedimet me Maqedoninë e Veriut. Sofja dëshiron të respektojë të drejtat e njerëzve me shtetësi bullgare në Maqedoninë e Veriut..

Shotë Galica

Qerime Halil Radisheva gruaja që shkroi me gërma të arta historinë e saj

Nënat e gratë tona hynë në histori me qëndresën e tyre, zunë vend në këngë me trimërinë e tyre, u mitizuan për besnikërinë dhe sakrificat e tyre, si Rozafa e Kalasë prej guri, si Doruntina..., që bijtë e tyre i nisën në luftë me fjalët: "Kthehuni fitimtarë"! Ndërsa, kur ata ktheheshin të gjakosur nga lufta, fjalët e nënave ua miklonin plagët.

Ishte nëna dhe gruaja shqiptare ajo, që u rezistoi të gjitha këtyre dhe nuk u dorëzua. Asaj, i kushtoheshin të gjitha, para së cilës populli ynë me respektin më të madh duhet të përkulet deri në gjunjëzim-para qëndresës dhe heroizmeve të Nënës Shqiptare. !

Respekti për nënat tona, denjësisht përcillet edhe në emrin e nënës, në emrin e gruas dhe në emrin e heroinës sonë kombëtare, Shote Galica, emër kaq i madh e i paharruar ndër breza, që zuri vend aq të madhërishtëm e të lavdishëm në historinë tonë kombëtare. Emri i saj përmban nder e krenari të lartë, është emër mburrje e lirie për të gjithë shqiptarët, kudo që janë. Është dashuri për Atdheun, pasion dhe frymëzim i qindra Shotave të reja, që ranë në ballë të luftës. Ato luftuan për çlirimin e Atdheut të robëruar, ashtu si Shotë Galica dikur dhe ranë për truallin amtar, për të mbrojtur jetët e sjella në jetë nga jeta e tyre. Denjësisht do e përfaqësonte figurën e gruas shqiptare të lodhur lufttrash dhe sfidash por kurrë të dorëzuar, Qerime Halil Radisheva ose siç e njohim me emrin e saj të luftës Shote Galica u lind në vjeshtën e 1895 në krahinë të Radishevës. Figura e saj edhe sot e kësaj dite frymëzon si gruaja e cila guxoi ta shkruajë vetë historinë e saj. Ajo mbetet një personazh historik avant-garde për kohën.

Edhe pse Qerimja ishte vajza e vetme mes gjashtë vëllezërve, ajo u rrit në kundërshtim me normat e çimentuara gjinore për kohën. Qerimja e shoqëronte të atin nëpër oda, në bisedat për luftën, aksionet dhe organizimin për çlirim nga pushtuesi i huaj. Këto ndikuan, që ajo të ndërrojë mendime dhe edukohet mbi situatën problematike të vendit qysh herët, prej kur edhe iu vunë nofka e trimërisë, "Shota".

Në pranverën e vitit 1915, Shota ishte ndër të rrallat gra që sfidoi mentalitetin e kohës, duke prishur një lidhje martesore me mblësëri, për të mos hequr dorë nga pavarësia e saj. Ajo u martua me Azem Bejtën në qershor, fill pas arratisjes së tij nga Burgu i Pozharevcit, ku gjendej si i burgosur politik. Megjithatë, tërheqja e tyre kish nisur më herët, në odën e shtëpisë së Shotës, gjatë mbledhjeve, ku diskutoheshin strategjitë politike. Ai do të shndërrohej në shokun e saj të jetës dhe të idealeve të përbashkëta për çlirim. Nga kjo marrëdhënie do të vinte



në jetë biri, Sandri, i cili nuk ia doli të mbijetojë më shumë se gjashtë muaj.

Në vitin 1919, Shota u angazhua në kryengritjen e Rrafshit të Dukagjinit. Në vitet 1922 - 1923, Shota luftoi për zonën neutrale të Junikut e cila shërbente si bazë për kryengritjen e Kosovës dhe Malësisë së Madhe. Pas vdekjes së Azemit në vitin 1924, ajo udhëhoqi çetën si kryekomandante e saj.

Dalja e Shotës, maleve e veshur si burrë, nuk u prit mirë nga bashkëluftëtarët e saj. Madje, për këtë arsye disa syresh zgjodhën, që ta braktisnin çetën. Lufta e saj ishte e dyfishtë: kundër pushtuesit të huaj dhe zakoneve prapanike të vendit.

Në këto luftime Shota humbi 22 pjesëtarë të familjes së saj: 4 vëllezërit dhe i shoqi u vranë në luftim e sipër, kurse nëna, motrat, nusët dhe fëmijët e vëllezërve u pushkatuan nga forcat shoviniste mizore serbe. Gjithë Kosova, në ato vite, ishte kthyer në vatër zjarri, ku

kur jepte kushtrimin: "Ooo prite, prite Azem Galicën, o heej!"... Shota edhe u plagos në luftë, por morali i saj nuk u thye asnjëherë, kështu duke u bërë shembull e krenari për ne.

Shota, po ndeshej me vdekjen dhe vdekja e saj, në atë moshë kaq të re, më shumë pati për pasojë moskujdesin njerëzor ndaj saj, ky moskujdes i qëllimshëm i një regjimi mbretëror antikombëtar kurorëzoi kushtet e një vdekjeje të parakohshme dhe të panatyrshme të një gruaje, që quhej Shote Galica, e cila ishte vetëm 32-vjeçare!...

E sëmurë nga plagët e marra në luftë, në kushte të tilla të vështira ekonomike e shëndetësore, Shota pati ardhur në fshatin Derven të Fushë-Krujës, me shpresën se do të ndihmohej, nga shteti i asaj kohe, por e zhgënjyer thellë, e tradhëtuar dhe e braktisur mizorisht, ajo vdiq më 20 korrik 1927. U varros sipas porosisë së vet, aty ku ishte qendra e Fushë-Krujës dhe rruga, që lidhte Shqipërinë me Kosovën.

Pas çlirimit të Atdheut, shteti shqiptar, duke e vlerësuar lart ndihmesën dhe sakrificat e Shote Galicës, i dha asaj titullin e lartë "Heroinë e Popullit". Më vonë emri i saj është përjetësuar në shkollën e mesme të Fushë-Krujës, si dhe është shpallur "Qytetare Nderi" e Fushë-Krujës.

Është në nderin e Fushë-Krujës, ku Shote Galica jetoi çastet e fundit të jetës së saj, vdiq dhe u varros këtu, duke sjellë me vete historinë e heroizmit të saj të pasqur, për të cilat dhe është vlerësuar lart nga gjithë spektri politik, që si qytet, si institucione shtetërore e organizata shoqërore, si komunitet e qytetarë të thjeshtë, që brez pas brezi ta kujtojmë e nderojmë jetën dhe veprën e saj, luftëtare e idealeve të mëdha kombëtare shqiptare dhe model për edukimin e brezave të rinj.

Nderim dhe mirënjohje për vlerat e jashtëzakonshme të bijeve dhe bijave më të mirë të këtij kombi!

Punoi: Anjeza Musollari



Shote e Azem Galica



AKTIVITETI

Komandanti i FD, Xhebexhia, merr pjesë në edicionin e 7-të "Sea Future 2021", Itali

Aktiviteti "Sea Future 2021", edicioni i 7-të, Simpoziumi i Biznesit për Teknologjitë Detare, u organizua nga Forca Detare italiane me mbështetjen e prefekturës në La Spezia, Itali. Ky aktivitet është unik në pellgun e Mesdheut me një qasje gjithëpërfshirëse të sektorit të mbrojtjes si dhe atij civil.

Në këtë aktivitet morën pjesë komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia dhe komandanti i Shërbimit Hidrografik, kapiten i rangut II Emrush Bejdo. Gjatë ditëve të aktivitetit komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Xhebexhia pati takim me komandantin e Forcës Detare italiane, admiral Giuseppe Cavo Dragone, i cili shprehu vlerësimin e tij për bashkëpunimin midis Forcave Detare si dhe u shpreh i gatshëm për ta çuar këtë bashkëpunim në një nivel

edhe më të lartë.

Komandanti i Forcës Detare shqiptare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia falënderoi admiralin për ftesën dhe pjesëmarrjen në aktivitetin "Sea Future 2021". Ai vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë midis vendeve tona për shumë vite si dhe u shpreh i gatshëm për të bashkëpunuar në fushat me interes të përbashkët. Komandanti i Forcës Detare theksoi se bashkëpunimi sa më i ngushtë midis forcave tona detare është çelës për arritjen e rezultateve në kontrollin e hapësirës detare. Në përfundim, komandanti i Forcës Detare u shpreh i gatshëm për të pritur në vendin tonë në vitin 2022.

Pjesë e aktivitetit ishte dhe workshop i Hidrografisë, i cili u drejta nga komandanti i Shërbimit Hidrografik italian, gjithashtu një përshëndetje e veçantë për aktivitetin u bë dhe nga drejtori i IHO si institucioni ndërkombëtar lider në këtë fushë.

Gjatë zhvillimit të workshopit u zhvillua ceremonia e diplomimit të kursit CAT-B. Në këtë kurs u diplomua dhe lejtënant Arbias Canameti, efektiv i Forcës Detare shqiptare, i cili ka ndjekur studimet si pjesë e planit të bashkëpunimit me Italinë për vitin 2021. Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte edhe gjeneral brigade Ilir Xhebexhia.

Gjatë ditëve të aktivitetit u zhvilluan takime me disa nga drejtuesit e delegacioneve të vendeve pjesëmarrëse. Gjatë takimeve u shkëmbyen kontakte si dhe diskutuar fusha të ndryshme potenciale për bashkëpunime në të ardhmen. Ndër takimet që mund të veçojmë është takimi me komandantin e Forcës Detare belge admiral Jan De Beurme i cili ftoi komandantin e Forcës Detare për një vizitë në Belgjikë.

